

VLERËSIMI I STATUSIT TË TË DREJTAVE TË JO-SHUMICËS NË KOSOVË



Vlerësimi i statusit të të drejtave të jo-shumicës në Kosovë

Porositësi i hulumtimit

OJQ Aktiv

Autorë të hulumtimit

Caleb Waugh

Igor Marković

Asistente e hulumtimit

Giulia Datovo

Donator

Qendra Ndërkombëtare Olof Palme

Për botuesin

OJQ Aktiv

Adresa:

Mbreti Petar 183a, Mitrovicë Veriore

Dritan Hoxha 17, Prishtinë

E-mail: office@ngoaktiv.org

Uebfaqja: www.ngoaktiv.org

Kopertina dhe dizajni

Krešimir Vogrinc

www.kvfinndesign.com

Mitrovicë Veriore, korrik 2021.

Përmbajtja

Hyrje	6
I. Të drejtat e komuniteteve jo-shumicë gjatë vitit të kaluar	10
II. Pjesëmarrja politike dhe përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë	24
III. Qasja në shërbime	38
IV. Çështjet sociale dhe ekonomike	58
V. Identiteti dhe trashëgimia kulturore	64
VI. Lidhjet me shtetet e tjera	72
VII. Komunitetet joshumicë me numër më të vogël	76
VIII. Tre interesa kryesorë të secilit prej komuniteteve joshumicë	82

Hyrje

Vitin që shkoi u shënua një sërë ndryshimesh që patën ndikim të ndjeshëm në drejtimin dhe natyrën e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve jo-shumicë dhe pushtetit qendror. Pandemia e COVID-19 ndryshoi në mënyrë rrënjësore peizazhin global politik, shoqëror dhe ekonomik, ndërkohë që rëndoi jashtëzakonisht burimet financiare e materiale dhe sprovoi aftësinë e qeverive për t'u ofruar shërbime zgjedhësve të vet. Mbi të gjitha, ajo shërbeu si një provë indikative lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut dhe aftësinë e institucioneve për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme mekanizmat e garantuar me kushtetutë për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në Kosovë, efektet e situatës së jashtëzakonshme në vazhdim e sipër në fushën e shëndetit publik treguan cenueshmërinë relative të komuniteteve jo-shumicë, si dhe mosrespektimin e vazhdueshëm të të drejtave të tyre në praktikën e përditshme qeveritare dhe në veprimet institucionale. Duke e pasur parasysh këtë, Vlerësimi i statusit të të drejtave të jo-shumicës në Kosovë, merr përmasa të ngutshme dhe rëndësi plotësuese, në orvatjen për të zbardhur më tej sfidat me të cilat përballen komunitetet jo-shumicë, si gjatë vitit që shkoi (2020), ashtu edhe në periudhën afatgjatë.

Gjatë disa viteve të fundit, OJQ AKTIV ka përcjellë me kujdes zhvillimin e situatës në komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Ngjarjet si nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit në vitin 2013, si dhe integrimi i përforcuar i komunitetit serb të Kosovës në sistemin kosovar sollën deri te ndryshime domethënëse shoqëro-politike dhe me të vërtetë nxitën ndryshime dramatike në dinamikën lokale. Peizazhi i ndryshuar gjithashtu krijoi situatën ku serbët e Kosovës dhe grupet e tjera jo-shumicë gjithnjë e më shumë janë të varura nga strukturat institucionale, ligjore dhe kushtetuese kosovare për mbrojtjen e të drejtave të veta themelore të njeriut dhe ekonomike, si dhe gjuhës dhe trashëgimisë së tyre kulturore. Këto rrethana e detyruan AKTIV-in që të krijojë një varg mekanizmesh për vrojtimin e natyrës së ndryshueshme të raportit mes qeverisë në nivelin qendror dhe komuniteteve jo-shumicë.¹ Mbi të gjitha, me synimin për të përcaktuar deri në ç'masë respektohen të drejtat e komunitetit në praktikë, por edhe për të vlerësuar cilësinë e përgjithshme të jetesës dhe pjesëmarrjes në sferën publike që e gëzojnë pjesëtarët e komunitetit. I nisur vitin që shkoi, Vlerësimi i statusit të të drejtave të jo-shumicës në Kosovë është një gur i rëndësishëm themeltar i këtyre përpjekjeve dhe paraqet analizën kumulative të të dhënave të mbledhura gjatë përcjelljes së aktiviteteve në shumë fusha të përcaktuara tematike të cilat përfshijnë të drejtat gjuhësore, qasjen në shërbime, trashëgiminë kulturore dhe fetare,

1 Për më shumë informacion: OJQ AKTIV, *Kriza e COVID-19: Reagimi aktiv i qytetarëve*, në dispozicion këtu: <http://www.ngoaktiv.org/news/covid19-crisis-active-citizens-response>

sigurinë, të drejtat pronësore dhe kthimin. Ndonëse raporti i mëparshëm u përqendrua kryesisht në komunitetin e serbëve të Kosovës, raporti i sivjetmë është zgjeruar për të përfshirë boshnjakët, goranët, komunitetet RAE dhe turqit.

Vlerësimi i statusit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë për vitin 2020 është një botim që, ndryshe nga raportet e një natyre të ngjashme, synon të hedhë dritë mbi perspektivën e qytetarëve të zakonshëm, pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë, për problemet me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë ose në mënyrë periodike, si dhe për interesat që vendimmarrësit duhet të marrin parasysh në një afat sa më të shkurtër. Në këtë drejtim, ekipi hulumtues zhvilloi katërbëdhjetë (14) grupe të fokusit me pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë në komunat e Kosovës ku ashkalinjtë, boshnjakët, egjiptianët, goranët, romët, turqit dhe serbët përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të popullsisë së përgjithshme. Përveç grupeve të fokusit me qytetarë, u zhvilluan tetëmbëdhjetë (18) intervista me përfaqësues të sektorit joqeveritar dhe medie, si dhe me vendimmarrës nga komunitetet jo-shumicë. Kjo qasje kërkimore kishte për synim të hulumtojë thellësisht si qëndrimet ashtu edhe interesat personale të komuniteteve jo-shumicë në tërësi, për të cilat nuk ka diskutim më të gjerë shoqëror dhe politik.

Përveç informacioneve të mbledhura gjatë hulumtimit brenda komuniteteve të përmendura, në këtë raport kanë kontribuar edhe analistë dhe studiues nga komunitetet jo-shumicë. Shqyrtimi analitik i implikimeve ligjore dhe praktike të kornizës legjislative të Kosovës që garanton të drejtat e komuniteteve jo-shumicë ishte një parakusht i domosdoshëm për të krijuar një publikim gjithëpërfshirës dhe informativ. Informacionet kthyes të mbledhura nga perspektiva e qytetarëve të zakonshëm, por edhe nga përfaqësues të shquar të komuniteteve jo-shumicë, u bashkuan në një raport qëllimi i të cilit është të informojë opinionin publik kosovar, por edhe rajonal, për pengesat në të cilat hasin pjesëtarët e komunitetit jo-shumicë. Ajo që është e rëndësishme të theksohet është se ky raport nuk pretendon të mbulojë të gjitha çështjet dhe temat kyçe me rëndësi për komunitetet jo-shumicë, por të provokojë një reagim nga institucionet qendrore dhe lokale, të cilat pa vonesa të mëtejshme do të merrnin më seriozisht faktet që do të paraqiten në faqet në vijim.

Ndonëse zgjedhjet për deputetët e Kuvendit u mbajtën në vitin 2021, u vendos që rezultatet e këtyre zgjedhjeve të përfshihen në këtë raport, përkundër faktit se ai mbulon vitin 2020. Arsyeja për këtë qëndron në faktin se një pjesë e konsiderueshme e fushatës politike filloi para janarit 2021 dhe se ajo kishte një ndikim në dinamikën socio-politike në komunitetet jo-shumicë.

I.

Të drejtat e komuniteteve jo-shumicë gjatë vitit të kaluar

Çështjet gjuhësore / Qasja në informacion

Përdorimi i gjuhës është një nga të drejtat themelore që kanë komunitetet jo-shumicë në Kosovë, qoftë në nivelin lokal (d.m.th. gjuhë në përdorim zyrtar) ose qendror (gjuhë zyrtare). Siç është cekur në raportet e mëparshme të OJQ AKTIV,^{2,3} zbatimi i dygjuhësisë në praktikën e përditshme është dëshmuar si sfidë e ndjeshme për sektorin publik.⁴ Presioni shtesë nën të cilin ishin agjencitë qeveritare gjatë pandemisë së COVID-19 vetëm sa e përkeqësoi problemin dhe zbuloi masën në të cilën zbatimi i dygjuhësisë i përcaktuar me kushtetutë mbetet i paarritshëm.

Për pjesëtarët e **komunitetit serb** të Kosovës, marrja e informacionit në gjuhën serbe në fillim të pandemisë ishte një çështje e gjithëpërhapur: qeveria kosovare nuk bëri përpjekje të mjaftueshme për të siguruar përkthimin e informacionit mbi masat e qeverisë dhe kufizimet e lirisë së lëvizjes.⁵ Kjo çoi në një situatë ku banorët u privuan nga informacioni i saktë i dorës së parë për atë që do të bëhej një krizë e madhe globale shëndetësore, shpesh duke u detyruar të mbështeten në burime mediatike, madje edhe thashetheme, për të qenë në rrjedha të zhvillimeve.

OJQ AKTIV, si pjesë e përpjekjeve të saj të rregullta monitoruese, shënoi shumë raste ku agjencitë nuk siguruan përkthime të udhëzimeve zyrtare, urdhrave dhe formave të tjera të njoftimeve për shtyp dhe deklaratave publike. Më evident ishte dështimi i përkthimit të direktivave të cilat përfshinin rregullat për vendkalimet kufitare, masat e karantinës, si dhe kufizimet e lirisë së lëvizjes (d.m.th. kush mund të largohet nga shtëpia e tyre dhe kur).⁶ Megjithëse nuk ka të dhëna konkrete, nga intervistat dhe grupet e

2 OJQ AKTIV, *Pengesat gjuhësore ndaj qasjes së barabartë të shërbimeve*, 2020, në dispozicion këtu: <http://www.ngoaktiv.org/uploads/files/Pengesat%20gjuh%C3%ABsore%20ndaj%20qasjes%20s%C3%AB%20barabart%C3%AB%20t%C3%AB%20sh%C3%ABrimeve.pdf>

3 OJQ AKTIV, *Raporti vjetor mbi gjendjen e të drejtave gjuhësore në Kosovë: Të drejtat gjuhësore në kohë pandemie*, 2021, në dispozicion këtu: <http://www.ngoaktiv.org/uploads/files/Raporti%20vjetor%20mbi%20gjendjen%20e%20t%C3%AB%20drejtave%20gjuh%C3%ABsore%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB.pdf>

4 OJQ AKTIV, *Dygjuhësia zyrtare në Kosovë - kushtet dhe sfidat kryesore*, 2021, në dispozicion këtu: <http://www.ngoaktiv.org/uploads/files/Dygjuh%C3%ABsia%20zyrtare%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB%20E2%80%93%20kushtet%20dhe%20sfidat%20kryesore.pdf>

5 Më 2 qershor 2020, Qendra Kombëtare për Menaxhimin Kufitar nxori udhëzime mbi procedurat për të hyrë në Kosovë në faqen e saj në Facebook, të cilat nuk i përktheu në gjuhën serbe:

<http://www.ngoaktiv.org/news/lost-in-translation-izgubljeni-u-prevodu-te-humbur-ne-perkthim>

6 Deklarata mbi shpalljen e kufizimeve të reja të lëvizjes pa përkthim në gjuhën serbe <http://www.ngoaktiv.org/news/new-restrictions-of-movement-in-kosovo-entered-into-force-without-official-translation-into-the-serbian-language>

fokusit mund të përfundohet se shumë banorë iu drejtuan rrjeteve sociale, ku ata shpesh merrnin vetëm informacion të pjesshëm dhe nganjëherë plotësisht të pasaktë. Kjo pati efektin e një reagimi zinxhir të përhapjes së të ashtuquajturave "lajme të rreme", që rezultoi në një mosbesim në rritje ndaj burimeve "zyrtare" të informacionit. Kjo ilustron nga rezultatet e një hulumtimi të opinionit publik të kryer nga OJQ AKTIV; vetëm rreth 31% e të gjithë të anketuarve thanë se ata respektuan 'plotësisht' rekomandimet e autoriteteve përkatëse (shëndetësore), numër ky që pasqyron një nivel të lartë mosbesimi ndaj informacionit 'zyrtar'.⁷

Në mënyrë të ngjashme, mediet në gjuhën serbe raportuan mbi problemet e shpeshta me qasjen të përfaqësuesit e qeverisë,⁸ marrjen e përkthimeve të njoftimeve për shtyp dhe përkthimin me gojë gjatë konferencave për shtyp. Tutje, institucionet treguan deri në një shkallë të përmbajtura në përfshirjen e gazetarëve serbë të Kosovës në linjat e komunikimit që përndryshe ishin të hapura për homologët e tyre shqiptarë. Për shembull, një listë e postës elektronike e krijuar nga Ministria e Shëndetësisë dërgonte informacion për mediet në gjuhën shqipe pa siguruar përkthimin në gjuhën serbe. Ky problem u manifestua gjithashtu në ndërveprim me institucionet e tjera, siç janë Policia e Kosovës dhe Ministria e Brendshme. Kjo ka zvogëluar aftësinë e medieve për të transmetuar informacione të sakta të publiku i gjerë në mënyrë efikase dhe të shpejtë, që do të thotë se serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera jo-shumicë u vendosën në një disavantazh të dukshëm dhe të matshëm kur bëhet fjalë për qasjen në informacion.

Komuniteti goran në Kosovë, ashtu si të gjitha komunitetet e tjera në Kosovë për të cilat gjuha shqipe nuk është gjuhë amtare, gjatë pandemisë u përball me probleme të ngjashme të cilat ishin jetike për respektimin e masave dhe ruajtjen e shëndetit publik. Informacioni dhe njoftimet në lidhje me vendimet e Qeverisë dhe masat e marra për mbrojtjen nga COVID-19, të shpallura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Kosovës për Shëndetin Publik në portalet e tyre në internet, shpesh ishin fillimisht të disponueshme vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa përkthimi në gjuhën serbe vononte nga disa ditë. Së këndejmi, pjesëtarët e komunitetit goran kishin qasje në informacionet mbi masat dhe vendimet e reja të qeverisë

7 OJQ AKTIV, COVID-19: *Në mes të realitetit dhe dezinformatave*, 2020, në dispozicion këtju:

http://www.ngoaktiv.org/uploads/files/Covid%2019_N%C3%AB%20mes%20t%C3%AB%20realitetit%20dhe%20dezinformative.pdf

8 Bazuar në intervistat me gazetarë që punojnë në mediet serbe të Kosovës në periudhën nga qershori deri në gusht 2020.

me vonesa të konsiderueshme ose merrnin informacione me gojë dhe jo të plota nga persona që deri diku e njohin gjuhën shqipe. Duke pasur parasysh faktin se ky komunitet është i përqendruar kryesisht në Komunën e Dragashit, njoftimet dhe pllakatet lidhur me pandeminë, për të cilat ishte përgjegjës pushteti lokal, dhe të cilat u vendosën në hapësira publike (shtëpi shëndeti, komunë, polici, shkolla, postë dhe institucione të tjera), nuk ishin në përputhje të plotë me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Një problem shtesë me të cilin përballen pjesëtarët e këtij komuniteti është para gjykatave dhe ka të bëjë me faktin që ata rregullisht shënohen në procesverbal si pjesëtarë të komunitetit boshnjak. Në fillim të procesit gjyqësor, gjyqtari thotë se pala është me kombësi boshnjake dhe se do të ofrohet përkthimi në gjuhën boshnjake, pa u pyetur fare për përkatësinë kombëtare.⁹

Komuniteti boshnjak, ashtu si ai goran dhe serb, u ballafaqua me pengesa gjuhësore të ngjashme, nëse jo të njëjta, kur bëhet fjalë për informimin në lidhje me masat e mbrojtjes gjatë pandemisë. Përkundër faktit se një numër i boshnjakëve¹⁰ dhe goranëve flasin gjuhën shqipe, informacioni i dhënë nga institucionet nuk arriti të përdoruesit fundorë në gjuhën e tyre amtare. Adresimet zyrtare, këshillat, rekomandimet dhe dokumentet e tjera të nxjerra nga institucionet përkatëse, të cilat mbi të gjitha kishin për qëllim luftimin e pandemisë, nuk u përkthyen. Si pjesë e aktiviteteve të saj për luftimin e pandemisë, Komuna e Prizrenit hapi një uebsajt të posaçëm me informacione rreth pandemisë, ku gjuha boshnjake nuk kishte seksionin e saj të veçantë.¹¹ Nga ana tjetër, në uebsajtin zyrtar të Komunës së Prizrenit gjatë pandemisë u botua vetëm një numër i vogël i lajmeve në gjuhën boshnjake, nga të cilat vetëm një kishte të bënte me pakot e ndihmave të përgatitura nga institucionet lokale ose qendrore për qytetarët dhe bizneset në Kosovë. Qytetarët e Komunës së Dragashit kishin një problem të ngjashëm me qasjen në informacione në gjuhën e tyre amtare. Këto vështirësi burojnë nga fakti që uebsajtet zyrtare të këtyre dy komunave nuk përfshijnë versione në gjuhën boshnjake për vite me radhë, duke i lënë kështu institucionet lokale pa kanale zyrtare për t'iu drejtuar komunitetit boshnjak. Një shembull i praktikës së tillë mund të gjendet te publikimi i vendimeve të kryetarit të Komunës së Prizrenit, ku

9 OJQ AKTIV, RAPORTI VJETOR MBI GJENDJEN E TË DREJTAVE GJUHËSORE NË KOSOVË: Të drejtat gjuhësore në kohë pandemie, 2020, në dispozicion këtu: <http://www.ngoaktiv.org/uploads/files/Raporti%20vjetor%20mbi%20gjendjen%20e%20t%C3%AB%20drejtave%20gjuh%C3%ABsore%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB.pdf>

10 Gjuha boshnjake është gjuhë zyrtare në komunat e Prizrenit dhe Dragashit, ndërsa deri në vitin 2015 ishte në përdorim zyrtar në Komunën e Pejës, kur me adoptimin e Rregullores për përdorimin e gjuhëve në Kuvendin Komunal të Pejës u shndërrua në gjuhë në përdorim zyrtar.

11 Uebsajti i Komunës së Prizrenit me informacione mbi pandeminë dhe virusin, në dispozicion këtu: <http://www.covidpz.com>.

në vitin 2020, ishin 366 vendime që u publikuan në gjuhën shqipe, por asnjë prej tyre nuk u përkthye në gjuhën boshnjake.¹² Një trajtim i ngjashëm jo-transparent u vu re në praktikën e publikimit të vendimeve të kryetarit të Komunës së Dragashit - asnjë nga 87 vendimet nuk është në dispozicion në gjuhën boshnjake.¹³

Sipas ekspertëve nga ky komunitet, boshnjakët në komunat e tjera ku ata përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të popullsisë së përgjithshme, janë të detyruar të përdorin uebsajtet zyrtare të institucioneve lokale dhe qendrore në versionet e disponueshme në gjuhën serbe. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit theksuan se mungesa e versioneve në gjuhën boshnjake e uebsajteve dhe informacioneve është pasojë e drejtpërdrejtë e barazimit institucional të gjuhës boshnjake me gjuhën serbe.

Kur bëhet fjalë për komunitetin rom / ashkali / egjiptian, Graçanica është komuna e vetme në Kosovë ku gjuha rome përdoret si gjuhë zyrtare në nivelin lokal, siç parashikohet në nenin 2 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Megjithatë, implementimi i kësaj dispozite dhe zbatimi praktik nuk kanë ekzistuar, pasi komuna nuk ka punësuar përkthyes për romët¹⁴ të cilët do të mund të përqendroheshin në përkthimin e dokumenteve publike në gjuhën rome. Në mënyrë që të promovojë më tej gjuhën dhe kulturën rome, Ministria e Arsimit ka miratuar mësimin e gjuhës dhe kulturës rome si lëndë zgjedhore në shkollat fillore në zonat ku jeton një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të komuniteteve RAE. Në këtë drejtim, Ministria gjithashtu organizoi përkthimin e librave në gjuhën rome dhe punësoi mësimdhënës romë. Plani fillestar ishte që ky program të nisë së pari në komunat e Prizrenit, Ferizajt, Gjakovës dhe Obiliqit, dhe pastaj në të gjitha komunat e tjera. Zbatimi i kësaj mase është ndërprerë në disa raste me arsyetimin se nuk ka buxhet për pagat e punonjësve. Gjatë pandemisë së COVID-19, pjesëtarët e komuniteteve RAE nuk kishin qasje në informacion në gjuhën rome dhe as qeveritë lokale ose qendrore nuk u përpoqën të lehtësonin ofrimin e informacionit në atë gjuhë.¹⁵

12 Uebsajti zyrtar i Komunës së Prizrenit – Zyra e kryetarit të komunës, në dispozicion këtu:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/staff/mytaher-haskuka/?page=37>

13 Uebsajti zyrtar i Komunës së Dragashit – Zyra e kryetarit të komunës, në dispozicion këtu:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2021/03/Vendimet-e-kryetarit-dhjetor-2020.pdf>

14 Informacione të mbledhura bazuar në deklaratat e pjesëmarrësve në grupet e fokusit

15 Informacione të mbledhura bazuar në intervistat me ekspertë nga komunitetet RAE, si dhe deklaratat e pjesëmarrësve në grupet e fokusit.

Sipas informacionit të mbledhur nga pjesëtarët e komunitetit turk, nuk kishte sfida të mëdha në qasjen në informacion në lidhje me masat e lëshuara nga institucionet, krahasuar me komunitetet e tjera jo-shumicë. Fakti që shumica e pjesëtarëve të këtij komuniteti flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe i ndihmoi ata të shmangin pengesat gjuhësore me të cilat përballen komunitetet e tjera. Në komunat e Prizrenit dhe Mamushës, ku jeton një pjesë e konsiderueshme e komunitetit turk, informacionet kyçe në lidhje me pandeminë e COVID-19 ishte në dispozicion në gjuhën turke. Kjo ishte si rrjedhojë e politikave gjuhësore të zbatuara në këto komuna, ku qasja në informacionin përkatës në gjuhën turke konsiderohet një praktikë standarde. Për më tepër, qytetarët e kombësisë turke vunë re se institucionet lokale kishin përmirësuar praktikën e tyre në drejtim të komunikimit me pjesëtarët e këtij komuniteti jo-shumicë në gjuhën e tyre amtare. Siç theksuan ekspertët nga ky komunitet, kjo është pjesërisht pasojë e pandemisë dhe urgjencës për ofrimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët, pa varësisht prejardhjes së tyre etnike ose fetare.

Masa 15

Nga fundi i marsit 2020, Qeveria e porsaformuar adoptoi një sërë masash ekonomike duke synuar zbutjen e pasojave socio-ekonomike të pandemisë. Kufizimet në funksionimin e gjithëmbarshtëm të veprimtarive ekonomike, si dhe në lirinë e lëvizjes, theksuan nevojën për ndihmë shtresave të rrezikuara të popullsisë, si dhe atyre që ishin më të prekur nga masat e reja. Në këtë drejtim, rasteve sociale iu dha mundësia të aplikojnë për ndihmë të disahershme ekonomike, e cila masë në tërësi arriti në rreth tre milionë euro. Për këtë qëllim, Qeveria dhe ministrinë formuan një platformë online përmes së cilës qytetarët e interesuar mund të aplikojnë për ndihmë. Parakusht për marrjen e kësaj ndihme ishte gjendja aktuale ekonomike individuale dhe familjare, që nënkuptonte sigurimin e dëshmive për të ardhurat personale.

Mirëpo, që nga fillimi, aplikuesit hasën në një sërë vështirësish gjatë procesit të aplikimit. Informacione të paqarta dhe shpesh jo të plota mbi procedurat dhe kriteret e aplikimit ishin të shpërndara në uebsajte të ndryshme të ministrive dhe agjencive përkatëse. Përkthimet e këtyre informacioneve në gjuhën serbe shpesh vonoheshin, ndërsa cilësia dhe kuptueshmëria e tyre ishte e diskutueshme. Për personat gjuha amtare e të cilëve është serbishtja, qasja në informacion ishte e kufizuar në këtë drejtim, duke e bërë të pamundur për pjesëtarët e komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera të kërkojnë ndihmë. Për më tepër, pikërisht për shkak të mungesës

së përkthimit me kohë dhe udhëzimeve të qarta procedurale, qendrat e punës sociale në komunat me shumicë serbe nuk ishin në gjendje t'u ofronin më shumë informacion aplikuesve të mundshëm.¹⁶

Pjesëtarët e komunitetit boshnjak dhe goran shprehën pakënaqësi për shkak të mungesës së përkthimit adekuat, si dhe problemeve teknike që hasën gjatë aplikimit për ndihmë. Me informacione pamjaftueshëm të qarta në lidhje me të drejtën për të aplikuar për pakon e masave në fjalë, pjesëtarët e këtyre komuniteteve jo-shumicë nuk ishin të informuar se cilave institucione duhet t'u drejtohen, për mënyrën e aplikimit, si dhe afatet për aplikim. Kur bëhet fjalë për komunitetin goran, pjesëtarët e popullatës më të re u përballën me vështirësi me rastin e regjistrimit në zyrën e punësimit, për shkak të faktit se faqja në internet e këtij institucioni nuk ofronte një mundësi për pjesëtarët e komunitetit goran për të deklaruar përkatësinë e tyre etnike, kështu që shumica prej tyre u deklaruan si boshnjakë. Për më tepër, pjesëtarët e këtyre dy komuniteteve të cilët u regjistruan me rregull si të papunë në zyrat e punësimit nuk morën një vërtetim të papunësisë në një numër të madh të rasteve. Megjithatë u bënë ankesa pranë këtyre zyrave, nuk kishte asnjë ndryshim në status, gjë që automatikisht pamundësoi marrësit potencialë të ndihmës nga aplikimi për ndihmë ekonomike.

Për shkak të vështirësive të lartpërmendura, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve u detyruan të kërkojnë ndihmë nga përfaqësuesit politikë të komuniteteve dhe nga organizatat e shoqërisë civile pasi iu mohua ndihma ekonomike. Sidoqoftë, sipas ekspertëve nga komuniteti goran dhe boshnjak, numri i atyre që potencialisht do të merrnin ndihmë u zvogëluar edhe për shkak të neglizhencës së qytetarëve lidhur me azhurnimin e dokumenteve zyrtare në institucionet kompetente, veçanërisht në lidhje me vërtetimet e bashkësisë familjare. Në shumicën e rasteve, vendimet për refuzimin e ndihmës për qytetarët u dorëzuan në gjuhën shqipe, pavarësisht nga fakti se në aplikimin për këtë ndihmë kishte një rubrikë për përzgjedhjen e kombësisë dhe gjuhës amtare, gjë që rezultoi në pamundësinë e ankimit ndaj vendimeve në përputhje me afatet ligjore.

Pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian hasën në një sërë pengesash gjatë aplikimit për ndihmë ekonomike që nuk i lejuan ata të kishin qasje në mënyrë adekuate. Pabarazia në qasjen ndaj ndihmës

¹⁶ <http://www.ngoaktiv.org/news/issues-of-non-majority-communities-with-the-implementation-of-a-package-of-measures-to-counter-the-economic-impact-of-the-coronavirus>

krahasuar me qytetarët e tjerë u pasqyrua me mungesën e informacionit themelor për procedurat dhe kushtet e aplikimit, si dhe pengesën gjuhësore që ekzistonte në mesin e një numri të konsiderueshëm të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve. Në mungesë të parakushteve teknike për aplikim (telefona celularë, laptopë) dhe, në shumë raste, për shkak të refuzimit të përfaqësuesve të institucioneve për të ndihmuar në procesin e aplikimit, komuniteti RAE u anashkalua në masë të konsiderueshme.

Komuniteti RAE u ballafaqua me vështirësi ekonomike shtesë gjatë pandemisë: ndonëse shoqëria civile nga komuniteti RAE, në bashkëpunim me komunat dhe me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, filluan të ofrojnë ndihmë emergjente, kjo rezultoi të jetë joadekuate. Prandaj, Qeveria Kurti njohu sfidat specifike me të cilat mund të përballen komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian dhe më 30 mars 2020, si pjesë e planit të Pakos Emergjente Fiskale, miratoi Masën 9: Mbështetje për iniciativat dhe projektet që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo-shumicë në Kosovë në vlerë prej 2,000,000 euro. Një masë e ngjashme u miratua gjithashtu më 13 gusht 2020 nga Qeveria Hoti, duke synuar nevojat specifike të komuniteteve pakicë me 2,000,000 euro. Në asnjë nga këto raste masat nuk u zbatuan plotësisht. Ndihma sociale e ofruar nga Qeveria nuk mbulonte minimumin e kostove të jetesës për ata kishin qenë pjesë e ekonomisë informale dhe ata që ktheheshin nga Evropa Perëndimore.¹⁷

Liria e lëvizjes

Kufizimet në lëvizjen e mallrave dhe personave, gjegjësisht mbyllja e kufijve dhe aeroporteve dhe rregulloret e rrepta për hyrjen dhe daljen, ishin dhe mbeten normë gjatë pandemisë së COVID-19. Në këtë kuptim, masat e paraqitura nga qeveria e parë Kurti në mars 2020 nuk devijuan nga ajo që shpejt u bë procedurë standarde në Evropë dhe në botë. Në këtë drejtim, ndërprerja e papritur e lidhjeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka pasur një ndikim negativ në komunitetet serbe të Kosovës, për shkak të mbështetjes së madhe në shërbimet shëndetësore të ofruara në qytetet e afërta si Nishi dhe Vranja, e lëre më për lidhjet familjare, personale dhe ekonomike që gëzonin shumica dërrmuese e serbëve të Kosovës.

¹⁷ Bazuar në një fokus grup të zhvilluar me pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në mars 2021.

Megjithëse lëvizja e kufizuar konsiderohet e nevojshme për të mbajtur nën kontroll situatën epidemiologjike, mënyra sporadike e futjes së masave kufizuese dhe fakti që informacioni përhapet shkaktuan huti: ndër detyrimet e paraqitura kur u mbyllën kufijtë ishte edhe detyrimi për çdo person që hyn në Kosovë të kalojë pesëmbëdhjetë (15) ditë në karantinë, por nuk ishte specifikuar se kush do të përjashtohet nga ky detyrim. Në një moment pas kësaj, u sqarua se kjo nuk do të vrente për “shoferët” dhe diplomatët. Sidoqoftë, situata mbeti konfuze dhe një numër shoferësh serbë pretendohet se ishin vendosur në karantina të ndryshme në Prishtinë. Kjo rezultoi në një situatë potencialisht të rrezikshme për shumë banorë të Kosovës, veçanërisht ata që jetojnë në dhe rreth Gjilanit (Kosova lindore), të cilët për shkak të vendndodhjes së tyre gjeografike mbështeten shumë në shërbimet shëndetësore të ofruara për ta në Serbi. Raportohet se afërsisht njëzet (20) serbë të Kosovës nga kjo zonë që lëngojnë nga sëmundjet e veshkave marrin rregullisht trajtim të dializës në qytetin e Vranjës në jug të Serbisë dy deri në tri herë në javë. Ndërsa udhëtimet mes Kosovës dhe Serbisë u bënë praktikisht të pamundura, ata u gjetën në një situatë ku (të paktën përkohësisht) nuk mund të kishin qasje në dializë.¹⁸ Drejtori i klinikës në Pasjan tha se, megjithëse ata arritën të shmangin vënien e këtyre pacientëve në karantinë, ata nuk ia dolën të mbërrijnë në Vranjë për shkak të faktit se shoferët e tyre që zakonisht i transportonin në spitalin e atjeshëm ishin vënë në karantinë nga policia e Kosovës.¹⁹ Është raportuar gjithashtu se autoritetet kosovare nuk kanë bashkëpunuar me institucionet lokale në komunitetet e serbëve të Kosovës për të identifikuar alternativat e mundshme, siç është ofrimi i mjekimit në qendrat shëndetësore që veprojnë brenda kornizës institucionale kosovare.

Mbrojtja dhe siguria

Për njëzet vitet e kaluara, siguria e **serbëve në Kosovë** ka qenë në krye të prioritetëve dhe interesave të këtij komuniteti. Mjedisi pas konfliktit, situata e paqëndrueshme politike, brishtësia e institucioneve, ndikimi i shpeshtë i narrativave nacionaliste në hapësirën publike dhe mungesa e garancive të sigurisë personale dhe kolektive kanë ndikuar ndjeshëm në percepti-

18 Deklarata mbi shpalljen e kufizimeve të reja të lëvizjes pa përkthim në gjuhën serbe: <http://www.ngoaktiv.org/news/new-restrictions-of-movement-in-kosovo-entered-into-force-without-official-translation-into-the-serbian-language>

19 Radio Kontakt Plus, *Pacientët nga Kosova me sëmundje të veshkave duhet të shkojnë në dializë, ndërsa shoferët e tyre në izolim*, 2020, në dispozicion këtu: <https://www.radiokontaktplus.org/vesti/bubreznici-bolesnici-sa-kosova-moraju-na-dijaliz-u-njihovi-vozaci-u-izolaciju/24831>

min negativ rreth mbrojtjes dhe sigurisë së komunitetit serb të Kosovës. Për më tepër, mungesa e një përgjigjeje adekuate dhe me kohë të institucioneve kompetente ndaj incidenteve që po ndodhnin në zonat e banuara nga pjesëtarët e këtij komuniteti (veçanërisht në komunitetet e kthyer) e ndërlikoi më tej jetën e tyre të përditshme. Rrjedhimisht, mosbesimi në institucione është intensifikuar, ndërsa numri i rasteve të pazgjidhura të rrezikimit të sigurisë private dhe të pronës ka qenë në rritje.

Në kushtet e pazakonta të pandemisë në Kosovë, fokusi i institucioneve lokale dhe qendrore ishte tërësisht në kërcënimin në rritje ndaj shëndetit publik. Në rrethanat e situatës së jashtëzakonshme, u krijua hapësirë shtesë për manovrim për rritjen e numrit të rasteve të veprimeve kriminale. Sipas të dhënave të mbledhura nga OJQ AKTIV, gjatë pandemisë u shënuar rritje në numrin e rasteve të rrezikimit të sigurisë private dhe pronësore në zonat e banuara nga pjesëtarët e këtij komuniteti. Nga fillimi deri në fund të vitit 2020, u përcaktua se në këto zona në Kosovë kanë ndodhur gjithsej 76 incidente, si vijon:

- njëzet (20) raste të sulmeve fizike ndaj pjesëtarëve të kombësisë serbe,
- shtatë (7) raste të djegies ose rrënimit të shtëpive (dhe/ose objekteve shoqëruese) në pronësi të personave me kombësi serbe,
- tetëmbëdhjetë (18) raste të thyerjes dhe grabitjes së pronave të personave me kombësi serbe,
- njëmbëdhjetë (11) raste të vjedhjes së pasurisë së luajtshme private,
- nëntë (9) raste të mbishkrimeve në objekte publike ose private, të cilat përmbanin gjuhë urrejtjeje ose mesazhe me qëllim të shkaktimit të provokimit në mesin e popullatës lokale,
- pesë (5) raste të sulmeve në pronën e institucioneve publike, dhe
- gjashtë (6) raste të dëmtimit të objekteve fetare të Kishës Ortodokse Serbe.

Mungesa e ndjekjes penale të kryesve të veprave penale të lartpërmendura dhe mungesa e dënimit publik të incidenteve nga zyrtarët treguan se praktika e gjertanishme e mos ofrimit të mbrojtjes për komunitetin serb ka vazhduar. Fakti që incidentet kanë ndodhur madje në 20 komuna në të gjithë Kosovën piketon drejtpërdrejt një problem që nuk është i natyrës lokale por të përgjithshme, i cili kërkon angazhim më serioz të institucioneve që rrjedh nga detyrimet e tyre ndaj qytetarëve siç përcaktohet me ligj. Mbulimi i kësaj çështjeje nga mediet dhe OJQ-të e komunitetit serb ashikare nuk ishte i mjaftueshëm për të tërhequr vëmendjen e publikut për këtë çështje të ngutshme.²⁰

20 Radio Mitrovica Sever, *Apeli nga platforma Empirica me rastin e cenimit të pasurisë së serbëve*, 2020, në dispozicion këtu: <http://radiomitrovicasever.com/2020/05/04/apel-empirike-povodom-ugrozavanja-imovine-srba-na-kim/>

Kur bëhet fjalë për komunitetin goran, gjatë vitit 2020, vjedhje dhe thyerje të shpeshta të shtëpive në pronësi të pjesëtarëve të këtij komuniteti u vunë re në fshatrat e komunës së Dragashit, të cilat ndodhen afër kufirit me Shqipërinë. Duke marrë parasysh faktin se banorët e këtyre fshatrave nuk janë në pronat e tyre dhe janë duke punuar përkohësisht jashtë vendit, në fshatrat Gilloboçicë, Zlipotok, Krushevë dhe Restelicë vjedhja e bagëtive të trasha, thyerja dhe grabitja e shtëpive të këtyre banorëve ishin të zakonshme. Përkundër faktit se secili prej rasteve ishte raportuar në mënyrë të rregullt në Policinë e Kosovës, sipas pohimeve të përfaqësuesve të këtij komuniteti, asnjë hetim nuk dha fryte dhe rrjedhimisht kryesit e këtyre veprave penale nuk u gjetën kurrë. Problemi është edhe më i madh sepse disa familje kanë pësuar dëme të mëdha materiale në disa raste me radhë. Banorët e fshatrave të lartpërmendura kërkuar nga policia që të rrisin numrin e njësive patrulluese në kalimet kufitare me Shqipërinë, pasi ata shprehën dyshimin se pasuria e tyre e paluajtshme dhe e luajtshme po rrezikohet nga banorët e vendeve kufitare nga Shqipëria. Megjithatë, kërkesat e qytetarëve nuk u morën parasysh dhe numri i patrullave të Policisë së Kosovës në rajon mbetet i njëjtë. Frika e popullatës lokale në fshatrat e lartpërmendura është akoma e përhapur, veçanërisht sepse, siç pohojnë vendasit, ata janë të brengosur për ekzistencën e një probabiliteti të lartë që incidentet të ndodhin edhe në të ardhmen.

Për dallim nga komuniteti goran dhe serb, **pjesëtarët e komunitetit turk dhe boshnjak** nuk janë ballafaquar me një kërcënim sistematik ndaj sigurisë personale dhe të pasurisë. Për më tepër, siç u konstatua gjatë bisedave me pjesëtarët e komunitetit turk në Mamushë dhe Prizren, siguria në zonat e populluara nga turqit u rrit ndjeshëm gjatë pandemisë. Problemet e komunitetit boshnjak që kanë të bëjnë me sigurinë i kanë rrënjët në vendimet e mëparshme të institucioneve të caktuara lokale (në komunën e Dragashit dhe Prizrenit) në lidhje me lejet për ndërtimin e mini hidrocentraleve, gurthyesve ose vendimet për dhënie e pronës publike në shfrytëzim personave privatë pa u konsultuar me popullatën lokale. Pjesëtarët e këtij komuniteti reagojnë në mënyrë kolektive ndaj vendimeve të tilla dhe në vitin 2020 u mbajtën protesta nga popullata lokale boshnjake kundër lëshimit të lejeve për ndërtimin e një gurthyesi në Podgorë dhe uzurpimit të sistemit të ujësjellësit rural në Novo Sellë.²¹

21 Kosova info, Foto: Po mbajnë protestë boshnjakët në Novo Sellë, 12.3.2021, në dispozicion këtu: <https://kosova.info/foto-u-toku-su-protesti-bosnjaka-novog-sela/>

Reagime të ngjashme ndodhën në rajonet e Zhupës dhe Gorës në lidhje me dhënien e pronës shoqërore në shfrytëzim, që u bë pa konsultim me vendasit, duke kryer kështu shkelje të drejtpërdrejtë të Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë. Nga ana tjetër, Parku Kombëtar Sharr dhe vendpushimi turistik Prevallë janë identifikuar si vende që shkaktojnë shqetësim në radhët e pjesëtarëve të komunitetit boshnjak në vitin 2020. Gjegjësisht, në disa raste në Prevallë u organizua protestë nga popullata lokale në lidhje me një numër të caktuar të vendimeve të ministrive që ishin ndesh me interesat dhe nevojat e komunitetit lokal boshnjak. Sipas popullatës lokale, protestat nuk dhanë fryte dhe zbatimi i vendimeve të diskutueshme vazhdoi.

Për komunitetin RAE, pjesa më e madhe e kërcënimit të përgjithshëm ndaj sigurisë së tyre personale dhe kolektive buron nga paragjykimet dhe diskriminimi me të cilin përballen në jetën e tyre të përditshme. Dëshmitë tregojnë se romët në Evropë vazhdojnë të pësojnë nga anticiganizmi - i njohur si një formë specifike e racizmit e nxitur nga paragjykimet dhe stereotipat - i përhapur dhe i vazhdueshëm. Më saktësisht, anticiganizmi është një histori e dhunës e persekutimit dhe e pasojave përkatëse negative socio-ekonomike për romët. Si dhe e përshkrimeve të tyre kulturore si ogure të fatit të keq, si të pabesë dhe me prirje kriminale. Ai gjithashtu përfshin qasje të pabarabartë në gjëra të tilla si uji i pastër dhe strehimi i sigurt. Papunësia në një përqindje jashtëzakonisht të lartë dhe jetëgjatësia në mënyrë drastike më e ulët është rezultat i paragjykimeve të përhapura në polici, gjyqësor, qeveri, sisteme të mbrojtjes sociale dhe shëndetësi, si dhe në shoqëri në tërësi. Një studim i paradokshëm i Barometrit Ballkanik i kryer nga Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal tregon se qëndrimet e komuniteteve shumicë në Ballkanin Perëndimor ndaj pakicës rome mbeten mjaft diskriminuese. Për shembull, 25% e të anketuarve thanë se e kishin siklet ose deri diku siklet të punojnë krahas romëve, ndërsa 27% thanë se e kishin siklet ose deri diku siklet të shoqërohen me një rom, ndërsa 26% e kishin siklet ose deri diku siklet kur fëmijët shkojnë në shkollë me fëmijët romë. Në fund, 68% thanë se e kishin siklet ose deri diku siklet të martohen ose të shohin të vetët të martohen me romët.

Për pjesëtarët e komuniteteve RAE në Kosovë, këto paragjyime shpesh mund të manifestohen në jetën e përditshme: Ndër të tjera, pjesëmarrësit e grupeve të fokusit përmendën raste të shumta të ngacmimit dhe diskriminimit, duke përfshirë sulmet verbale ndaj grave të reja të komuniteteve RAE nga shoferët lokalë.

Më 11 shtator 2020, Kryeministri i Kosovës mori një Vendim për krijimin e një Grupi Punues Teknik për mbrojtjen nga diskriminimi të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve, të kryesuar nga Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë, i cili do të jetë përgjegjës, ndër të tjera, për zbatimin e përgjegjësive nga Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në kuadër të Procesit të Zgjerimit të BE-së.

II.

Pjesëmarrja politike dhe përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë

Zgjedhjet dhe përfaqësimi politik

Serbët e Kosovës përfaqësohen në Kuvendin e Kosovës me dhjetë (10) deputetë, të cilët zgjidhen sipas sistemit të listave partiake. Megjithatë pjesëmarrja në zgjedhjet e Kosovës është rritur në mënyrë të vazhdueshme që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit në 2013,²² shumë pjesëtarë të komunitetit kanë shprehur shqetësim për dominimin e vazhdueshëm të Listës Srpska në hapësirën publike. Lista Srpska ka pretenduar në disa raste të ndryshme se ajo është përfaqësuesja e vetme e vërtetë e interesave serbe në Kosovë dhe paraqet imazhin që figurat e opozitës janë në duart e interesave të huaja.²³ Kjo taktikë ka hasur në sukses të konsiderueshëm, pasi aktualisht nuk kanë opozitë të ndjeshme, as në nivelin lokal dhe as në atë qendror.²⁴

Çështja e të drejtave të votimit për qytetarët me qëndrim jashtë Kosovës është temë e shumë diskutimeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për personat e zhvendosur që jetojnë në Serbinë qendrore. Gjatë zgjedhjeve të fundit, të mbajtura në tetor 2019, lindi polemika për shkak të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) që vetëm ata që kanë dokumente të vlefshme të lëshuara nga institucionet e Kosovës do të mund të votojnë. Kjo u dënua ashpër nga partitë politike që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë, duke përfshirë Listën Srpska, duke pohuar se një vendim i tillë mund të çojë në mohim të gjerë të të drejtës për ata që përndryshe do të mund të ushtronin të drejtën e tyre të votës.²⁵ Megjithatë burimet dhe vlerësimet dallojnë, numri i personave të zhvendosur në Serbi nga Kosova shkon nga rreth 72,000 (Kombet e Bashkuara) deri në pothuajse 200,000 (Qeveria e Serbisë). Është e panevojshme të thuhet që ata përbëjnë një bllok të konsiderueshëm votimi, veçanërisht për partitë që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë. Një burim tjetër i polemikave gjatë ciklit të fundit zgjedhor në 2019 ishte çështja e fletëvotimeve “të helmua” e cila u shfaq pasi dolën raportet se njëzet e gjashtë (26) punonjës të KQZ-së kishin pësuar reagime të ndryshme alergjike pas përpunimit të fletëvotimeve me postë që vinin nga Serbia qendrore. Hetimi pasues tregoi që efektet e padëshiruara nuk ishin rezultat i një sëmundjeje infektive, por nuk u publikuan rezultate më konkrete mbi shkakun dhe burimin e saktë.

22 Analiza e trendeve, OJQ AKTIV, Mitrovicë Veriore, 2020, f. 27.

23 Shih: https://www.rtv.rs/sr_ci/politika/srpska-lista-opozicija-nanosi-stetu-srbima-na-kosmetu_954176.html

24 Shih: <https://kossev.info/cik-potvrdio-rezultate-izbora-lvv-58-poslanickih-mesta-srpska-10/>

25 Shih: <https://balkaninsight.com/2019/09/12/kosovo-minority-leaders-denounce-illegal-voting-rule/>

Në zgjedhjet e mbajtura në vitin 2021, përsëri u ngritën një sërë pyetjesh në lidhje me lehtësinë e votimit nga jashtë, që kësaj here ndikonte dhe përfshinte një gamë të gjerë të aktorëve politikë. Kishte pyetje në lidhje me situatën kur KQZ-ja në janar 2021 vendosi që votuesit do të përballeshin me verifikim plotësues të identitetit në formën e një telefonate gjatë së cilës pritej që votuesit të konfirmimin të dhëna të ndryshme personale.²⁶ Ky hap mjaft i pazakontë shkaktoi habi në mesin e aktivistëve të shoqërisë civile, të cilët pohuan se kjo paraqet një shkelje të mundshme të të drejtave të votimit të pjesëtarëve të diasporës së madhe kosovare. OJQ GERMIN me seli në Prishtinë dorëzoi ankesë pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parash-tresa (PZAP), duke argumentuar se një veprim i tillë është antikushtetues. Më tej u vërejt se rregullat e reja çojnë në konfuzion të konsiderueshëm në mesin e votuesve të mundshëm në Serbi, duke përfshirë faktin që numrat e telefonit të dhënë si numra falas për regjistrimin e votuesve ose nuk janë funksionale ose informacioni nuk është i disponueshëm në gjuhën serbe.²⁷

Një çështje tjetër e përhershme dhe ende e pazgjidhur është lista e votuesve dhe e drejta për të votuar. Bashkimi Evropian në raportin e vet mbi zgjedhjet parlamentare 2019 deklaroi sa vijon: “Saktësia dhe besueshmëria e listës së votuesve është një problem i kahershëm i zgjedhjeve në Kosovë. Numri i votuesve të regjistruar në Kosovë është më i madh sesa numri i vlerësuar i popullsisë së Kosovës. Kjo anomali shpjegohet pjesërisht me faktin se shumica dërrmuese e diasporës së Kosovës u përjashtua nga regjistrimi i vitit 2011, megjithëse është ende e regjistruar ligjërisht në librat amë të të lindurve. Për më tepër, lista e votuesve përfshinte shumë persona të vdekur sepse nuk ka një sistem efektiv për heqjen e tyre sistematike nga lista.” Ky problem ka të bëjë drejtpërdrejt me votimin jashtë Kosovës, i cili mbetet sfidë për shumë; në të njëjtin raport, BE-ja përmendi afatet e regjistrimit si një pengesë e mundshme për regjistrimin e papenguar të votuesve. Probleme të ngjashme duket se kanë lindur gjatë ciklit zgjedhor 2021, me raportime se shumë të zhvendosur të kombësisë serbe kanë pasur vështirësi në procesin e regjistrimit të votuesve. Mediet lokale gjithashtu kanë raportuar se listat e votuesve të regjistruar për komunat në veri të Kosovës ishin zvogëluar për rreth 16,000 persona, për shkak të vdekjeve, por edhe për shkak të faktit se dokumentet personale të UNMIK-ut nuk prano-hen më për qëllime votimi.²⁸

26 KQZ-ja do të verifikojë procedurën e aplikimit për regjistrim duke kontaktuar të gjithë aplikuesit përmes telefonit... Nëse aplikuesi nuk përgjigjet në telefon, aplikimi i tij do të refuzohet.

27 Bazuar në intervistat me pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës dhe komuniteteve tjera jo-shumicë në mars 2021.

28 Shih: <https://kossev.info/umanjen-spisak-biraca-sa-severa-kosova-i-broj-birackih-mesta/>

Përpara zgjedhjeve të shkurtit 2021, kishte mungesë të propozimeve konkrete nga partitë politike të shumicës shqiptare në lidhje me marrëdhëniet e tyre me komunitetet jo-shumicë. Në lidhje me këtë, gjatë një interviste të dhënë gjatë fushatës 2019, Albin Kurti u shpreh se Ligji për Përdorimin e Gjuhëve duhet të shfuqizohet dhe të zëvendësohet me një ligj të ri që do ta bënte gjuhën serbe gjuhë zyrtare vetëm në komuna të përzgjedhura. Në vitin 2021, Programi i Shkurtër Politik, i disponueshëm në faqen e internetit të Lëvizjes Vetëvendosje, në kuadër të pjesës për drejtësinë rendit “strukturat paralele të Serbisë” si një nga njëmbëdhjetë (11) “fusha të rëndësishme të veprimit”.²⁹ Aty më tej bëhet thirrje për “decentralizim” që nuk merr parasysh përkatësinë etnike: *“Decentralizimi duhet të bazohet në nevojat dhe interesat e qytetarëve, jo në parimet etnike.”*

Ndonëse Kurti foli më pak për këtë gjatë ciklit zgjedhor 2021, në vitin 2019 ai u përpoq të vendoste kontakte me komunitetin serb të Kosovës dhe deklaroi në disa raste se ishte në favor të dialogut të drejtpërdrejtë me serbët e Kosovës.³⁰

Partia Demokratike e Kosovës ka marrë një qëndrim më agresiv kur bëhet fjalë për serbët e Kosovës dhe ndërsa manifesti i saj bënte thirrje për “respekt të ndërsjellë” për të drejtat e pakicave në Kosovë dhe Serbi (serbët në Kosovë dhe shqiptarët në Luginën e Preshevës), ajo refuzoi kategorikisht idenë e një Asociacioni të Komunave Serbe me çfarëdo formë të pushtetit ekzekutiv, duke pohuar se kjo “do të tejkalonte të drejtat e dhëna pakicave në Kosovë.”³¹ PDK-ja shkoi më larg se partitë e tjera, duke pohuar se Serbia kishte kryer “gjenocid” në Kosovë dhe duke kërkuar që udhëheqësit serbë të kërkojnë falje, duke pretenduar më tej se do të kërkonte që sistemi arsimor serb të përfshinte “krimet serbe” në tekstet mësimore në mënyrë që shoqëria serbe të mos “kultivonte urrejtje” ndaj fqinjëve të saj.³² Megjithëse nuk ishin parashtruar plane ose propozime konkrete për të zvogëluar të drejtat ligjore të komuniteteve jo-shumicë, programi i PDK-së përdor gjuhë të fortë dhe shpesh agresive kur flet për serbët dhe Serbinë, duke premtuar në një moment reciprocitet për “politikat shkatërruese” të Serbisë.

Lideri aktual i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka një histori të deklaratave publike që janë armiqësore ndaj serbëve dhe Serbisë. Për shembull, në një postim të botuar në vitin 2019, Hoxhaj postoi një deklaratë (nga Novo Bërda) në pro-

29 Program i Shkurtër Politik, Vetëvendosje, f. 13.

30 Shih: <https://www.info-ks.net/vijesti/kosovo/103904/kurti-za-rasica-i-petrovica-ima-mjesta-u-vladi-kosova-video>

31 Programi Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës, f. 45.

32 Po aty, f. 45.

filin e tij në Facebook duke akuzuar Serbinë për 'përvetësimin' e trashëgimisë etnike të Kosovës.³³ Tutje, në korrik 2020, ai publikoi një deklaratë, gjithashtu përmes Facebook-ut, ku tha se Kosova kishte përmbushur detyrimet e saj ndaj të zhvendosurve serbë nga Kosova, se kjo "temë është e mbyllur që prej 15 vjetësh."³⁴

Megjithëse bashkësia ndërkombëtare vlerësoi përgjithësisht se zgjedhjet e vitit 2021 për Kuvendin e Kosovës ishin të lira dhe korrekte, u shënuan parregullsi në komunat e Kosovës me shumicë serbe, veçanërisht në veri.³⁵ Para zgjedhjeve, deputetja Duda Balje ngriti akuzat se ishte lidhur një marrëveshje në prapaskenë ndërmjet Adriana Hodžić (Ujedinjena Zajednica - Boshnjak), Gazmend Salijević (RAE) dhe Listës Srpska për të siguruar votat e komuniteteve boshnjake dhe RAE për të mbështetur Listën Srpska për Kuvend, duke siguruar kontrollin e tyre mbi njëzet (20) vendet e rezervuara për komunitetet jo-shumicë.³⁶ Në ditën e zgjedhjeve, raportet në rrjetet sociale tregonin se një numër i madh serbësh votuan për partinë e Adriana Hodžić. Kjo më vonë u konfirmua kur u bë tabelimi i votave dhe doli se ajo mori disa mijëra vota në komunat Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.³⁷ Në atë kohë, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa mori vendim për të anuluar rreth 4,000 vota që Hodžić kishte marrë në komunat me shumicë serbe,³⁸ për këtë arsye ajo pastaj parashtrroi ankesë, që më pas u refuzua nga Gjykata Kushtetuese.³⁹ Kjo shkaktoi reagim të ndjeshëm në mesin e komunitetit serb të Kosovës, ku shumë mohuan idenë e parregullsive të përhapura dhe të votimit taktik të parashtruar nga aktorët politikë nga radhët e shqiptarëve të Kosovës dhe nga bashkësia ndërkombëtare.

Ndonëse **komuniteti goran** në nivelin qendror ka përfaqësuesin e vet politik të garantuar me ligj dhe deputetin në Kuvendin e Kosovës, viteve të fundit zëri i komunitetit goran është dëgjuar dobët, sipas ekspertëve nga ky komunitet. Sipas këtyre pohimeve, përfaqësimi politik i komunitetit goran përbëhej nga emërimi i goranëve në poste të larta politike (zëvendësministër, këshilltarë), të cilët në të vërtetë morën funksionet vetëm për përfitime financiare. Pa përvojë dhe njohuri të mëparshme në lidhje me funksion-

33 <https://www.facebook.com/dr.enverhoxhaj/posts/1960235574078185>

34 <https://www.facebook.com/dr.enverhoxhaj/posts/2674307239337678>

35 Shih: <https://balkaninsight.com/2021/03/08/kosovo-election-panel-cancels-manipulated-bosniak-and-roma-votes/>

36 Shih: <https://prishtinainsight.com/balje-srpska-lista-interfering-in-elections/>

37 Shih: <https://rezultatet2021.org/>

38 Shih: <https://balkaninsight.com/2021/03/08/kosovo-election-panel-cancels-manipulated-bosniak-and-roma-votes/>

39 Shih: <https://www.slobodnaevropa.org/a/31141264.html>

imin e institucioneve, gjer më tani, zyrtarët e kombësisë gorane nuk kanë qenë në gjendje t'i dalin ndesh komunitetit të tyre dhe t'i informojnë institucionet për interesat, problemet dhe nevojat e komunitetit.

Në nivelin lokal, komuniteti goran përfaqësohet në Kuvendin Komunal të Dragashit me katër (4) këshilltarë nga tre (3) opsione të ndryshme politike dhe dy (2) drejtorë të drejtorive. Sidoqoftë, sipas vendasve, bashkëpunimi i tyre i ndërsjellë në interes të komunitetit është i pakënaqshëm, veçanërisht për faktin se këshilltarët që përfaqësojnë interesat e goranëve mund të ndikojnë në masë të madhe në shpërndarjen e investimeve kapitale nga buxheti komunal në të mirën e komunitetit të tyre.

Në zgjedhjet parlamentare, për vendin e rezervuar për komunitetin goran në Kuvend garuan një koalicion i përbërë nga dy parti politike (Pokret za Gora – PG dhe Građanska inicijativa Gore – GIG) dhe opsioni politik Jedinstvena goranska partija – JGP. Duke marrë parasysh faktin se baza kryesore e trupit votues të komunitetit goran gjendet në territorin e Komunës së Dragashit, të dy opsionet politike morën mbështetjen më të madhe nga votuesit. Megjithatë, vetë zgjedhjet nuk u zhvilluan në një atmosferë demokratike dhe të ndershme. Gjegjësisht, në fshatin Vranishtë, ku ekziston një organ i përkohshëm i Komunës së Gorës (sipas sistemit të Republikës së Serbisë), para vetë zgjedhjeve, sipas pohimeve të banorëve të atjeshëm, pjesëtarët e komunitetit goran ishin nën presion dhe u kërcënuan se do t'u ndaleshin të ardhurat sociale nëse në zgjedhje nuk e mbështetnin njërin nga dy opsionet politike të përmendura.

Procesi zgjedhor në mjediset e banuara nga pjesëtarët e **komunitetit boshnjak** në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2020 në Kosovë u zhvillua qetë, pa incidente të mëdha që do të rrezikonin rrjedhën e zgjedhjeve. Sipas ekspertëve nga ky komunitet, kjo praktikë demokratike është dëshmuar në disa zgjedhje radhazi dhe është një tregues i praktikës pozitive demokratike që tashmë është e qëndrueshme. Sidoqoftë, në disa fshatra të Podgorës, Zhupës, Gorës, por edhe në qytetin e Prizrenit, ka disa cikle zgjedhore që një numër jo i vogël i qytetarëve janë përballur me problemin e pamundësisë për të përcaktuar vendvotimin në vendqëndrimet e tyre dhe nuk është e pazakontë që pjesëtarët e këtij komuniteti të jenë në listat e votuesve në njësi banimi të cilat nuk përkojnë me vendqëndrimin e tyre të përhershëm. Mungesa e informacionit në mesin e qytetarëve boshnjakë në lidhje me mundësinë e paraqitjes së një kërkesë elektronike për ndryshimin e vendvotimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve krijon pengesa të pakapërcyeshme për një numër të konsiderueshëm të pjesëtarëve të këtij komuniteti të cilët kanë shprehur dëshirën për të ushtruar të drejtën e tyre të votës.

Komunitetit boshnjak i garantohen tri vende në Kuvend, të cilat ofrojnë mundësi të mjaftueshme dhe hapësirë të konsiderueshme për manovrim për veprimtari politike dhe ndikim në proceset politike në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Por, sipas analistëve politikë nga ky komunitet, ashtu si vitet e mëparshme, edhe viti 2020 u shqua me mosmarrëveshje mes përfaqësuesve politikë boshnjakë në lidhje me përfaqësimin e përbashkët të interesave dhe rrjedhimisht zgjidhjen e problemeve të boshnjakëve, gjë që tërthorazi ia mundësoi partive kryesore të koalicionit qeverisës që të mos merren në mënyrë aktive me çështjet e këtij komuniteti jo-shumicë.

Gjatë dekadës së kaluar, Partia Demokratike Turke (shkurt TDP, nga gjuha turke *Türk Demokratik Partisi*) ka dominuar skenën politike në nivelin lokal, si për nga mbështetja në komunitet ashtu edhe për nga ulëset në parlament. Sipas pjesëtarëve të komunitetit, kjo pasqyron perceptimin e përgjithshëm se mbështetja politike duhet të konsolidohet në një parti për të siguruar artikulum më efektiv të interesave kolektive në nivelin institucional.⁴⁰ Megjithëse kishte përpjekje për të formuar parti opozitare, ato ishin kryesisht të pasuksesshme për të paraqitur një kërcënim të ndjeshëm për dominimin nga TDP. Kjo pasqyrohet në faktin se, pas Listës Srpska, Partia Demokratike Turke mori përqindjen më të lartë të votave për një parti politike që përfaqëson një komunitet jo-shumicë.⁴¹

Kushtetuta e Kosovës garanton vende në parlament për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, me të paktën një anëtar nga secili prej këtyre komuniteteve dhe një vend shtesë për komunitetin që merr më shumë vota, një nivel ky i përfaqësimit politik që mbase pak komunitete të tjera rome e gëzojnë. Në zgjedhjet e fundit më 14 shkurt 2021, qindra kandidatë romë, ashkali dhe egjiptianë garuan për ato katër vende. Mirëpo, varfëria me të cilën përballen komunitetet RAE ndikon në drejtimin e përgjithshëm të udhëhequr nga përfaqësuesit e tyre politikë dhe mund t'i kufizojë ata në role më të vogla në proceset e vendimmarrjes. Varfëria dhe mungesa e qasjes në informacionin përkatës gjithashtu i bëjnë komunitetet e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve më të prekshme nga mashtrimet zgjedhore dhe manipulimet politike.

40 Bazuar në një grup të fokusit të zhvilluar në Mamushë në mars 2021.

41 Shih: <https://rezultatet2021.org/>

Liria e shprehjes / medieve

Situata e përgjithshme në lidhje me lirinë e medieve në Kosovë është e përzier dhe ndërsa kushtetuta garanton lirinë e shprehjes dhe lirinë e medieve, gazetarët shpesh përballen me sulme për trajtimin e çështjeve të ndjeshme.⁴² Kur bëhet fjalë për lirinë e medieve dhe fjalën e lirë në **komunitetin serb të Kosovës**, janë vënë re shabllone të ngjashme në kuptimin që gazetarët janë përballur me sulme fizike dhe forma të tjera të frikësimit në lidhje me raportimin e tyre. Sulmues ende të paidentifikuar sulmuan pronarin e stacionit televiziv “RTV Puls” në prill 2020, përpara ndërtesës së Organit të Përkohshëm të Komunës së Mitrovicës.⁴³ Deri në publikimin e këtij raporti nuk ishte bërë asnjë arrestim dhe hetimi policor kryesisht nuk arriti të hedhë dritë mbi çfarëdo motiv të mundshëm prapa sulmit. Gazetarë të tjerë kanosen dhe abuzohen vazhdimisht.

Përveç kanosjeve me dhunë fizike, gazetarët serbë të Kosovës shpesh hasin pengesa për punën e tyre nga një klimë politike kufizuese dhe mungesa e vullnetit nga ana e institucioneve qeveritare për të lehtësuar qasjen në informacion, një problem ky me të cilin ata përballen si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Një shembull i kësaj mund të jetë RTV MIR, një stacion televiziv në Leposaviq, të cilit iu ndalua transmetimi pasi MTS DOO mori pronësinë mbi ofruesit e shërbimeve kabllorike në nivel lokal. MTS DOO është degë e MTS Serbia, e cila është kompania shtetërore e telekomunikimit.⁴⁴ Ngjarja ishte shqetësuese sepse kishte të bënte me ‘mbylljen e gojës’ së një mediumi lokal, i cili shihej si kritik ndaj partisë në pushtet (në Beograd dhe në komunitetet serbe të Kosovës) dhe nxiti perceptimin se mediet të cilat nuk ‘ndjekin vijën partiake’ përballen me forma të ndryshme të hakmarrjes. Në të njëjtën mënyrë, mediet e pavarura gjithashtu pohojnë se përballen me vështirësi në ndërveprim me institucionet lokale, pasi ekziston një shkallë e caktuar e selektivitetit kur bëhet fjalë për përfaqësuesit e shtypit të cilët do të japin deklarata / informacione.⁴⁵

Komuniteti turk në Kosovë ka fare pak të punësuar në sektorin e medieve. Për të mbijetuar, organizatat ekzistuese të medieve në këtë komunitet kanë tendencë të mbështeten në projektet e financuara nga donatorët.

42 KosSev, *Kosnet: Sulmet ndaj gazetarëve janë sulme ndaj demokracisë*, 2020, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/kosnet-napadi-na-novinare-su-napadi-na-demokratiju/>

43 OJQ AKTIV, *Njoftim*, 2020, në dispozicion këtu: <http://ngoaktiv.org/news/saopstenje-za-javnost-njoftime-per-shtyp-press-release>

44 OJQ AKTIV, *Empirika: Kthimi i RTV MIR në transmetim*, 2020, në dispozicion këtu: <http://ngoaktiv.org/news/empirika-returning-rtv-mir-to-the-air-omoguciti-emitovanje-rtv-mir-te-mundesohet-transmetimi-i-rtv-mir>

45 <http://ngoaktiv.org/news/public-statement>

Krahas kësaj, televizioni dhe radioja shtetërore e Kosovës punëson vetëm pesë (5) pjesëtarë të komunitetit turk. Përveç portaleve të lajmeve në rrjetet sociale, kohë pas kohe ka edhe emisione në dispozicion në gjuhën turke.

Komuniteti boshnjak në Kosovë ka qasje në hapësirën mediatike që kryesisht mbështetet te redaksitë në gjuhën boshnjake në televizionin RTK 2, si dhe te stacionet e radios dhe portalet informative në internet, të cilat me staf dhe kapacitet të kufizuar teknik arrijnë të ndajnë informacione themelore me pjesëtarët e këtij komuniteti. Kjo hapësirë mediatike nuk është e ngarkuar me kufizime të dukshme lidhur me lirinë e fjalës dhe, sipas përfaqësuesve të medieve në gjuhën boshnjake, gazetarët dhe mediet në redaksitë, stacionet e radios dhe portalet e informacionit në gjuhën boshnjake kanë lirinë të trajtojnë tema që janë jashtëzakonisht të rëndësishme për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të këtij komuniteti. Sidoqoftë, ata përmendin se përballen me hapësirë shumë të kufizuar brenda programit të televizionit të përmendur dhe me një numër të punonjësve të cilët shpesh nuk kanë mundësi të trajtojnë në mënyrë adekuate temat kyçe me rëndësi shoqërore. Krahas kësaj, gazetarët e intervistuar vunë në dukje problemin e një numri të caktuar të medieve që i nënshtrohen ndikimit të liderëve partiakë nga radhët e komunitetit boshnjak, dukuri kjo që ata besojnë se është pasojë e mbështetjes së pamjaftueshme financiare dhe logjistike për mediet lokale në gjuhën boshnjake.

Shoqëria civile

Shoqëria civile në **komunitetet serbe në Kosovë** është e vendosur kryesisht në Mitrovicën veriore dhe në Graçanicë, me organizata më të vogla joqeveritare (OJQ) që veprojnë në komuna të tjera. Mitrovica e Veriut është seli e veçantë për një numër të madh të OJQ-ve që merren me një sërë çështjesh sociale, ekonomike dhe politike, nga marrëdhëniet ndëretnike te të drejtat e grave dhe çështjet mjedisore. Në mënyrë të ngjashme, Graçanica shërben si qendër e shoqërisë civile për serbët që jetojnë në jug të lumit Ibër, megjithëse në një shkallë shumë më të vogël se në Mitrovicën e Veriut. Ndikimi i njëanshëm i veriut në jetën e qytetarëve është kryesisht për shkak të faktit se një pjesë e konsiderueshme e fondeve të donatorëve u drejtohet OSHC-ve që e kanë selinë atje, duke i lënë shpesh jashtë rrjeteve të financimit organizatat më të vogla në komunitetet më të izoluar.⁴⁶ Meg-

⁴⁶ Bazuar në intervistat dhe grupet e fokusit të zhvilluara me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në shkurt dhe mars 2021.

jithëse kjo qasje ka të bëjë me fuqinë dhe kapacitetin e shumë OJQ-ve të serbëve të Kosovës, shumë prej të cilave punësojnë deri në 10-15 pjesëtarë të stafit, shoqëria civile në zonat me më pak të mbuluara, siç janë Kosova lindore dhe perëndimore, është e pazhvilluar dhe shumica e OJQ-ve e mbajnë veten falë granteve të vogla. Në këtë drejtim, ekziston një numër i OSHC-ve me seli në zona të tilla si Gorazhdeci, Parteshi, Ranillugu dhe Sillova të cilat, me gjithë vështirësitë në qasjen ndaj mundësive të mbështetjes financiare, megjithatë kanë arritur të inkurajojnë aktivizmin lokal, veçanërisht në mesin e të rinjve. Ata hapën qendra rinore, mbështetën ngjarje sportive dhe kulturore dhe lehtësuan shpërndarjen e ndihmës humanitare gjatë pandemisë së COVID-19.⁴⁷ Në veri të Kosovës, një studim i kryer për përgatitjen e këtij raporti identifikoi dhjetë (10) organizata aktive të shoqërisë civile me seli në Mitrovicën e Veriut dhe Zveçan, nga të cilat të paktën 2-3 kanë një staf prej 10-15 personash.⁴⁸ Shumë nga këto organizata janë gjithashtu aktive në hulumtimin dhe analizën e politikave dhe mund të ushtrojnë njëfarë shkalle të ndikimit në proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal, si dhe atë qendror.⁴⁹ Tendenca është që organizatat e tyre homologe në jug të lumit Ibër të jenë dukshëm më të vogla dhe të kenë qasje më të kufizuara në burimet materiale dhe financiare.

Korniza ligjore e Kosovës përmban një varg dispozitash mbi pjesëmarrjen e OJQ-ve në jetën politike dhe institucionale (si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror), gjë që për shumë përfaqësues të shoqërisë civile paraqet sfida për zbatim në praktikë. Aktivistët e shoqërisë civile shpesh ankohen për kufizimet që ua vendosin forcat e jashtme politike, të cilat shpesh i bëjnë ata të ndiejnë detyrim për të ushtruar një shkallë të vetë-censurës gjatë trajtimit të çështjeve të ndjeshme.⁵⁰ Presioni i jashtëm mund të vijë si nga niveli lokal dhe qendror, ashtu edhe nga rreziku (i perceptuar ose i vërtetë) për trajtimin e tabuve sociale që mund të rezultojnë në reagime negative nga komunitetet lokale. Duket se ekziston gjithashtu një ndarje mes OJQ-ve që konsiderohen se janë në favor të institucioneve lokale dhe/ose partive politike dhe atyre që janë kritike ndaj tyre, ku të parat gëzojnë mundësi më të mira financimi nga burimet qeveritare dhe të dytat përjashtohen nga kanalet e bashkëpunimit dhe komunikimit zyrtar.⁵¹

47 Po aty

48 Bazuar në hulumtimin e zhvilluar nga organizatat jo-qeveritare në veri të Kosovës, të cilin e kreu OJQ AKTIV në shkurt dhe mars 2021.

49 Bazuar në intervistat dhe grupet e fokusit të zhvilluara me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në shkurt dhe mars 2021.

50 Po aty

51 Po aty

Gjithashtu, shumë përfaqësues të OSHC-ve lanë të kuptohet se ndiheshin të shtrënguar nga imponimi i fushave të ndërhyrjes të identifikuar paraprakisht nga organizatat donatore, gjë që rezultoi në ngurrim për të adresuar nevojat e komunitetit që nuk ishin në mesin e atyre prioriteteve.⁵² Kjo mbase pasqyrohet në faktin se ende, shumë vite pas viteve 1990, ekziston një hendek mjaft i gjerë mes OJQ-ve dhe komuniteteve të cilave ato i shërbejnë, meqë në mesin e përfituesve dhe banorëve vendas ekziston perceptimi i pranuar gjerësisht se shoqëria civile u shërben interesave të jashtme dhe jo të brendshme.

Organizatat jo-qeveritare turke në Mamushë dhe Prizren janë të përqendruara kryesisht në ofrimin dhe shpërndarjen e ndihmës ekonomike për turqit e Kosovës (shpërndarjen e mallrave dhe ofrimin e granteve për aplikuesit për aktivitete të ndryshme), si dhe në përmirësimin e mundësive për të rinjtë. Aktualisht, ka vetëm disa organizata aktive të komunitetit turk që, sipas informacionit të mbledhur gjatë grupeve të fokusit dhe intervistave me ekspertë, nuk janë të dukshme brenda vetë komunitetit. Për më tepër, OJQ-të janë kritikuar gjerësisht që kanë dështuar të përqendrohen në përmirësimin e mbrojtjes së kulturës dhe gjuhës turke në Kosovë.

Sipas përfaqësuesve të **komunitetit goran**, organizatat joqeveritare që merren me çështjet me interes për këtë grup etnik, janë shumë pasive dhe pothuajse nuk marrin pjesë në kurrfarë aktiviteti praktik. Përkundër faktit se ka një numër të konsiderueshëm të OJQ-ve të regjistruara që vijnë nga ky komunitet, pak sosh realizojnë projekte me interes për goranët, qoftë në nivelin qendror ose atë lokal. Disa angazhohen çdo vit me rastin e shënimit të 6 majit, ditës përkujtimore të komunitetit goran në Kosovë (Dita e Shën Gjergjit), ku mbështetja për organizimin e ngjarjeve ofrohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjë që kufizon ndjeshëm hapësirën e përgjithshme për promovimin e komunitetit. E vetmja organizatë jo-qeveritare e komunitetit goran me seli në Prishtinë që vepron në nivelin qendror është “Shoqata e Grave Gora” (*Udruženje žena Gora*), e cila në kuadër të aktiviteteve të saj punon në promovimin e veshjeve tradicionale gorane. Kritikta drejtuar organizatave që vijnë nga komuniteti goran është se ato nuk marrin pjesë në përcjelljen e punës së organeve të vetëqeverisjes lokale dhe nuk zbatojnë asnjë projekt që do të përmirësonte bashkëpunimin me komunitetet e tjera. Sipas ekspertëve, me këto dhe fusha të ngjashme merren kryesisht organizatat e komunitetit shumicë shqiptar në territorin

e Komunës së Dragashit në bashkëpunim me shoqërinë civile boshnjake. Mosorganizimi dhe pasiviteti i shoqërisë civile të komunitetit goran ndikon në informimin e vetë komunitetit dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën publike në Kosovë, por gjithashtu flet për mungesën e kapacitetit të tyre për të udhëhequr me projekte, si dhe mungesën e partneriteteve të ndërtuara me OJQ-të ndërkombëtare.

Shoqëria civile në **komunitetin boshnjak** është përqendruar kryesisht në promovimin dhe avancimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë, zhvillimin dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, si dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Gjatë vitit 2020, aktivitetet e organizatave joqeveritare nga ky komunitet u mbajtën kryesisht në formatin online, me çka u kufizua ndjeshëm shtrirja e arritjes së synimeve të projektit ose programit. Qasja në fondet e parapara për komunitetet jo-shumicë në institucione të caktuara në nivelin qendror dhe lokal ishte e kufizuar edhe në vitin 2020. Jotransparenca në proceset e vendimmarrjes gjatë ndarjes së subvencioneve, ndërhyrjet politike në përzgjedhjen e projekteve si dhe vonesat e mëdha në transferimin e mjeteve financiare për zbatimin e projekteve janë problemet kryesore të organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë interesat e komunitetit boshnjak. Këto mangësi janë aq me ndikim, veçanërisht duke marrë parasysh faktin se mbështetja për organizatat e shoqërisë civile në shumicën e rasteve vjen nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal. Për më tepër, pozita e palakmueshme e shoqërisë civile në radhët e këtij komuniteti bëhet edhe më e ndërlikuar, siç theksohet nga përfaqësuesit e organizatave boshnjake, nga i ashtuquajti "lulëzim" i organizatave të afërta me qarqet politike, për të cilat ka dyshime në lidhje me punën dhe produktet e dukshme, si dhe ndikimin që kanë në zhvillimin e komunitetit boshnjak në Kosovë.

Ekziston një numër i organizatave jo-qeveritare **që punojnë në komunitetet e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve**, shumica e të cilave ofrojnë shërbime sociale dhe shpërndajnë forma të ndryshme të ndihmës humanitare.⁵³ Mbi të gjitha, ka një varg organizatash jo-qeveritare me seli në Prishtinë që kanë përfshirë komunitetet e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në përpjekjet ose aktivitetet e tyre, qoftë në nivelin lokal ose në avokim në nivelin e vendimmarrjes / nivelin politik. Përkitazi me këtë, gjatë grupeve të fokusit pjesëtarët e komunitetit shprehën dyshime lidhur me këto organizata, duke thënë se ekzistonte një përshtypje e përgjithshme

53 Bazuar në një fokus grup të zhvilluar në mars 2021 me pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Graçanicë.

që ata shpesh i shfrytëzojnë si anëtarë “simbolikë” të komunitetit të tyre për të marrë mbështetjen e donatorëve. Një pjesëmarrës në hulumtim përmendi një shembull kur ata morën pjesë në një ngjarje të organizuar nga një organizatë me seli në Prishtinë dhe organizatori shprehu pakënaqësinë e tij sepse “ata nuk dukeshin mjaftueshëm romë për të bërë fotografi”.⁵⁴ Duket se ka ngurrim për të pranuar organizatat “e jashtme” të shoqërisë civile, me një farë shkalle skepticizmi lidhur me qëllimet e tyre për shkak të paragjytimeve të përhapura shoqërore me të cilat përballen aktualisht pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.⁵⁵

⁵⁴ Deklarata e një pjesëtari të komunitetit RAE në Graçanicë, mars 2021.

⁵⁵ Bazuar në një fokus grup të zhvilluar në mars 2021 me pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Graçanicë.

III.

Qasja në shërbime

Disponueshmëria e shërbimeve në komunitetet e cenushme

Ofrimi i shërbimeve për komunitetet jo-shumicë në Kosovë ka paraqitur sfidë të konsiderueshme për institucionet e mirëqenies sociale dhe institucionet e tjera “parësore” që ofrojnë shërbime mjekësore, arsimore dhe sociale në zonat e pambrojtura. Ndërsa komunat me shumicë serbe, veçanërisht ato në veri, gëzojnë qasje të afërt dhe relativisht të lehtë në institucionet publike, zonat e tjera të populluara me serbë në përfundim të Kosovës përballen me sfida shumë më të mëdha kur bëhet fjalë për qasjen në shërbimet themelore. Në masë jo të vogël, arsyeja për këtë është izolimi gjeografik dhe shoqëror nga qendrat më të mëdha me një **shumicë serbe** të popullsisë, siç janë Mitrovica e Veriut ose Graçanica. Për më tepër, shumë prej këtyre komuniteteve përballen me një shkallë të lartë të izolimit ekonomik, papunësisë dhe mungesës së përfaqësimit politik që përndryshe do të mund të shërbente për t’iu përgjigjur sistematikisht nevojave të tyre në nivelin e vendimmarrjes.

Për sa i përket qasjes në shërbimet publike që ofrohen për **romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët**, fusha më sfiduese mbetet sektori i shëndetësisë, që u përkeqësua më tej gjatë pandemisë. Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët ankohen për mospërfillje dhe diskriminim nga personeli mjekësor për shkak të përkatësisë së tyre etnike.⁵⁶ Sidoqoftë, situata në arsim dhe punësim është më ndryshe, pasi institucionet publike kanë miratuar masa të veprimit afirmativ për të promovuar përfshirjen e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në arsim dhe punësim. Gjegjësisht, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka ndarë bursa për nxënësit e shkollave të mesme nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian për të promovuar dhe mbështetur vazhdimin e arsimimit të tyre në nivelin e lartë, ndërsa Agjencia Kombëtare e Punësimit ka adoptuar kuota të veçanta për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët për aftësimin profesional dhe ndërtimin e kapaciteteve profesionale.

Qasja në shërbimet parësore dhe dytësore për pjesëtarët e **komunitetit boshnjak** është motivi kryesor për kërkesat gjithnjë e më të zëshme për procesin e formimit të komunave me shumicë të popullsisë boshnjake në Kosovë. Kërkesa për formimin e komunave të këtij lloji ka dalë prej vitesh si një nga kërkesat kryesore të këtij komuniteti, rreth së cilës, siç u konstatua gjatë hulumtimit të kryer për qëllimet e këtij publikimi, ekziston një

56 Bazuar në një fokus grup të zhvilluar në mars 2021 me pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Graçanicë.

konsensus unik shoqëror. Boshnjakët në komunat e Prizrenit, Dragashit, Istokut dhe Pejës jetojnë kryesisht në zona rurale, me një numër jo të vogël sosh që jetojnë në zona urbane. Për të parët, gjegjësisht banorët e zonave rurale, disponueshmëria e shërbimeve të ofruara nga institucionet lokale dhe qendrore është një nga problemet kryesore të këtij komuniteti. Kur kërkojnë shërbime të një natyre themelore administrative, sipas pretendimeve të banorëve të këtyre mjediseve, pjesëtarët e këtij komuniteti janë të detyruar të shpenzojnë mjete të konsiderueshme financiare në mënyrë që të arrijnë të marrin shërbimet e kërkuara. Siç theksojnë ekspertët nga radhët e komunitetit boshnjak, ky problem buron nga fakti që zyrat e ndara komunale (si ajo në fshatin Reçan) nuk i plotësojnë nevojat e vendasve për sa i përket numrit dhe cilësisë së shërbimeve që ofrojnë. Së këndejmi, siç pretendohet, ekziston uniteti i pjesëtarëve të këtij komuniteti në dëshirën për të decentralizuar administratën në të mirën e boshnjakëve.

Kujdesi mjekësor në komunitetet e cënueshme / komunitetet e izoluar

Ndonëse të gjitha komunat me shumicë serbe në Kosovë mund të mburren me klinika shëndetësore dhe / ose spitale (siç është rasti në Mitrovicën e Veriut dhe Graçanicë), qendra të punës sociale, shkolla (institucione të arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë) dhe një prani të madhe policore, shumë zona të populluara me serbë vuajnë nga një shkallë izolimi që në të vërtetë i ndan ata nga jeta institucionale. Kjo është veçanërisht e theksuar në Kosovën lindore dhe perëndimore, ku komunitetet janë të ndara nga ofruesit e shërbimeve si në sistemin institucional serb ashtu edhe në atë kosovar: Shumë fshatra / komunitete të mbuluara nga ky hulumtim nuk kanë një qendër / klinikë funksionale shëndetësore, që do të thotë se ata duhet të udhëtojnë për në Osojan, Shtërpçë, Mitrovicë të Veriut, Gorazhdec ose Graçanicë. Për shembull, fshatrat si fshati Crkolez në Kosovën lindore kanë vetëm një prani institucionale shumë të kufizuar,⁵⁷ që do të thotë se banorët varen nga shërbimet që ofrohen nga institucionet në komuna më të largëta, siç janë Mitrovica e Veriut ose, më rrallë, Istogu.

Pavarësisht nga fakti se shumë banorë zotërojnë automjete motorike, fakti që ata nuk kanë qasje të lehtë në kujdesin mjekësor (sidomos në situata të jashtëzakonshme) është një burim shqetësimi pothuajse i vazhdueshëm.⁵⁸ Edhe pse u tha se qasja të ofruesit e kujdesit shëndetësor për tra-

57 Bazuar në hulumtimet në terren të kryera në Kosovën perëndimore nga shkurti deri në mars 2021.

58 Intervistat e zhvilluara në një fshat në perëndim të Kosovës të kryera në mars të vitit 2021.

jtimit rutinë ose themelor është e mundur, ekziston një mungesë qartësie kur bëhet fjalë për kujdesin urgjent (p.sh. në rast sulmi kardiak ose në rast të lëndimeve të rënda) sepse spitali më i madh në perëndim të Kosovës (në Osojan) jo gjithmonë u përgjigjet thirrjeve.⁵⁹ Për më tepër, shumë banorë lokalë ose nuk dinë si të kontaktojnë shërbimet e urgjencës (gjegjësisht ndihmën e shpejtë) që veprojnë brenda kornizës ligjore të Kosovës ose nuk kanë dëshirë t'i përdorin shërbimet e tyre.⁶⁰ Siç deklaroi një banor i fshatit Crkolez: “Është në rregull nëse keni nevojë të shkoni te mjeku për vizitë, por Zot na ruaj nëse dikush pëson sulm në zemër, nuk e di nëse do të arrijnë këtu me kohë.”⁶¹ Për më tepër, ofruesit e kujdesit shëndetësor që aktualisht punojnë në Kosovën perëndimore nuk janë medoemos plotësisht të pajisur për të ofruar shërbime të spektrit të gjerë dhe banorët lokalë janë të detyruar të shkojnë tutje nëse e shohin veten se kanë nevojë për kujdes më të specializuar.⁶²

Komunitetet e tjera në atë zonë përballen me situata të ngjashme, ndërsa banorët që nuk kanë automobil përballen me udhëtime të gjata. Banorët e këtij rajoni, veçanërisht në zona më të izoluar dhe më të largëta, thanë që transporti nga dhe për në komunat me shumicë serbe për kujdes shëndetësor / ekzaminime mjekësore dhe punë të tjera administrative rutinë është i vështirë, për shkak të faktit se nuk ka linja të rregullta të autobusëve dhe furgonëve të cilat do t'i lidhnin këto me vende më të mëdha (qofshin ato me shumicë serbe ose shqiptare). “Nëse nuk keni automobil, nuk ka asnjë mënyrë për të shkuar në Mitrovicë ose Graçanicë.”⁶³ Për këto arsye, banorët që përballen me probleme shëndetësore që kërkojnë shtrim në spital ose trajtim afatgjatë përballen me periodha të konsiderueshme kohe të kaluara larg shtëpisë, gjë që rëndon më tej anëtarët e familjes.

Disponueshmëria e kujdesit shëndetësor parësor, mungesa e mjekëve dhe personelit teknik mjekësor në zonat e populluara nga boshnjakët u bënë çështje veçanërisht të dukshme gjatë pandemisë. Për shembull, në zonat me një numër të konsiderueshëm boshnjakësh gjatë vitit 2020 disa dhjetëra vendbanime mbetën pa mjekë të praktikës së përgjithshme për shkak se ata migruan ose shkuan në specializim, ndërsa Komuna e Prizrenit disa herë anuloi konkursin për mjekë të rinj - proces ky që u zgjat dhe

59 Po aty

60 Po aty

61 Intervistë me një banor të fshatit Crkolez e zhvilluar në mars të vitit 2021.

62 Bazuar në intervistat me banorët e Kosovës perëndimore të zhvilluara në mars të vitit 2021.

63 Po aty

ende nuk është përfunduar plotësisht. Mungesa e stafit mjekësor është karakteristike për zonat e largëta rurale, kështu që në rajonet e Zhupës dhe Gorës mungon stafi mjekësor dhe ekziston kërkesa për mjekë nga fusha specifike të kujdesit mjekësor (siç është gjinekologjia).

Arsimi

Bazuar në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (shkurt CPS, nga gjuha angleze *Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement*), komnatat kanë të drejtë të marrin mjete financiare⁶⁴ nga Republika e Serbisë për ushtrimin e përgjegjësisë në fushat e kompetencave të veta, duke përfshirë arsimin.⁶⁵ Propozimi gjithashtu parashikon që shkollat të cilat ofrojnë mësim në gjuhën serbe mund të zbatojnë plan-programe ose tekste mësimore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë, me njoftim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT).⁶⁶ Prandaj, sipas Kushtetutës⁶⁷ dhe në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale,⁶⁸ Ligji për Arsimin në Komuna përcakton që komnatat mund të bashkëpunojnë - ndër të tjera - me institucionet dhe agjencitë qeveritare në Republikën e Serbisë.⁶⁹ Së këndejmi, shkollat të cilat ofrojnë mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan-programe ose tekste mësimore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Serbisë, me detyrimin për të njoftuar MASHT-in.⁷⁰ Mirëpo, në rast të paraqitjes së çfarëdo vërejtjeje nga ana e MASHT-it për plan-programin ose tekstin mësimor të dorëzuar për njoftim, ligji parashikon themelimin e një komisioni të pavarur për t'i shqyrtuar ato.⁷¹

64 Sidoqoftë, siç është saktësuar, komnatat mund të pranojnë ndihma të tilla financiare nga Republika e Serbisë nëpërmjet xhirollogarive në bankat komerciale të autorizuar nga Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës, ndërsa pas kësaj duhet të njoftojnë Thesarin Qendror për çdo pranim të tillë (Aneksi III, neni 11.1.2). Për më tepër, çdo donacion financiar dhe shpenzimet gjegjëse duhet të raportohen në buxhetet komunale (Aneksi III, 11.1.3).

65 Aneksi III, neni 11.1

66 Po aty, neni 7

67 Kapitulli X mbi qeverisjen lokale dhe organizimin territorial, neni 124.4

68 Neni 30.2. Në dispozicion këtij: <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/06/Ligji-per-Veteqeverisje-Lokale.pdf>

69 Ligji nr. 03 / L-068 për Arsimin në Komuna, neni 4.3.

Në dispozicion këtij: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/9ligji-i-arsimit-ne-komuna2008-03-1068-al-ar-se-kom.pdf>

70 Po aty, neni 12.2

71 Po aty, neni 12.4

Institucionet e Kosovës dhe më saktësisht MASHT-i e kanë detyrim kushtetues⁷² zhvillimin dhe ofrimin e plan-programit në gjuhën serbe. 2009. MASHT-i⁷³ themeloi një Komision të Pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe si pjesë e reformës së arsimit parauniversitar. Komisioni asokohe propozoi një sërë masash të përkohshme që do të ndërmerreshin nga MASHT-i për të monitoruar dhe siguruar arsimin në gjuhën serbe me plan-programe mësimore dhe tekste mësimore që vijnë nga Republika e Serbisë, derisa të zhvillohen kurrikula të plota në gjuhën serbe brenda sistemit arsimor të Kosovës. Mirëpo, deri më sot, as institucionet e Kosovës nuk kanë iniciuar procesin e zhvillimit të një plan-programi të veçantë në gjuhën serbe në konsultim me përfaqësuesit e komunitetit, përfaqësuesit e fushës së arsimit nga sistemi i drejtuar nga serbët edhe në Kosovë edhe në Republikën e Serbisë; as shkollat me plan-program serb nuk i kanë dërguar njoftime MASHT-it lidhur me përdorimin e plan-programeve mësimore dhe teksteve mësimore nga Serbia.

Sipas hartëzimit të sistemit arsimor të administruar nga Serbia, të kryer nga Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave (shkurt ECMI, nga gjuha angleze *European Centre for Minority Issues*), në vitin 2018 në Kosovë kishte rreth 11,900 nxënës të regjistruar në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, ndërsa 5,500 në arsimin e mesëm të lartë në gjithsej 69 shkolla filllore dhe të mesme të ulëta, 34 shkolla të mesme të larta dhe 141 paralele të ndara.⁷⁴

Trashëgimia e së kaluarës së afërt krahas paqartësisë ligjore që krijoi kushtet për ekzistencën e dy sistemeve të ndryshme arsimore ka rezultuar në segregacion të mëtejme të nxënësve sipas plan-programeve të ndryshme. Kjo shfaqet edhe më qartë në shkollat e përbashkëta: nga nëntë komunat⁷⁵ ku ekzistojnë shkolla të tilla, në asnjërën nuk është regjistruar bashkëpunim formal ose praktika të institucionalizuara që promovojnë aktivitete të përbashkëta dhe dialog ndërkulturor, me disa përjashtime të një natyre thjesht financiare dhe teknike.⁷⁶ Disa mundësi për ndërveprim mes nxënësve në objektet e përbashkëta nuk janë pothuajse kurrë

72 CPS Aneksi II mbi të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të komuniteteve, neni 3.1, paragrafi (b); dhe Kushtetuta, neni 59.2
73 Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN), një zyrë e themeluar në pajtim me Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe vepron si instanca e fundit në Kosovë për interpretimin e dispozitave të Planit, përcaktoi që Komisioni është i nevojshëm.

74 ECMI Kosovë, "Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë", nëntor 2018: f. Në dispozicion këtu:

https://www.ecmikosovo.org/uploads/Arsimimi%20në%20gjuhën%20Serbe%20në%20Kosovë_SHQ.pdf

75 Sipas Misionit të OSBE-së në Kosovë (2018), Dragash, Fushë Kosovë, Gjilan, Kamenicë, Kllokot, Lipjan, Novo Bërdë, Obiliq dhe Viti Misioni i OSBE-së në Kosovë, "Qasja e komuniteteve në arsimin parauniversitar në Kosovë", dhjetor 2018. Në dispozicion këtu:

<https://www.osce.org/mission-in-kosovo/406952>

76 Po aty

falë angazhimit të vendasve, por iniciohen nga organizata ndërkombëtare (ON) ose organizata joqeveritare (OJQ), siç janë për shembull orët e gjuhës shqipe në Obiliq, të organizuara dhe të financuara nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë në kuadër të projektit *“Përkrahja e përafrimit përmes arsimit për demokraci dhe të mësuarit të gjuhëve.”*⁷⁷

Arsimi asnjëherë nuk është adresuar në mënyrë holistike në kuadër të dialogut teknik ose në Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013, megjithëse përmendet në mesin e kompetencave që Asociacioni / bashkësia e komunave me shumicë serbe do të kishte nën pikën 4 të Marrëveshjes së Parë mbi Parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve (ose Marrëveshja e Brukselit).⁷⁸ Përfundim u bë për marrëveshjen për njohjen e diplomave të arsimit të lartë, e cila fillimisht u referohej ekskluzivisht diplomave të lëshuara nga institucionet arsimore në Republikën e Serbisë dhe në Kosovë, duke lënë jashtë ato të lëshuara nga sistemi arsimor në Kosovë i drejtuar nga Serbia.⁷⁹ Mirëpo, në maj 2015, ECMI ndërmjetësoi në një udhë për verifikimin e diplomave ndërmjet MASHT-it dhe Universitetit të Mitrovicës së Veriut (shkurt USM, nga gjuha serbe *Univerzitet Severne Mitrovice*).⁸⁰ Përkundër procesit të verifikimit të njohjes së ndërsjellë të diplomave nga shkolla fillore deri në doktoratë, duke përfshirë diplomat e lëshuara nga USM, bisedimet e mirëfillta dypalëshe për vendosjen e marrëdhënieve ndërmjet sistemeve arsimore në Kosovë ende nuk kanë filluar.

Veçanërisht në lidhje me kurrikulën e Kosovës, MASHT-i nuk ka arritur të integrojë rekomandimet e Komisionit të Pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe nga viti 2010 për krijimin e një kurrikule në gjuhën serbe. Zhvillimi i një kurrikule në gjuhën serbe padyshim që do të nënkuptonte nisjen e një diskutimi të hapur mbi përmbajtjen e teksteve mësimore të historisë dhe së këndejmi do të nevojitet një vullnet i mirë-

77 <https://www.coe.int/en/web/education/fostering-rapprochement-through-education-for-democracy-and-language-learning-fred>

78 Marrëveshja e Parë mbi Parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve (2013). Në dispozicion këtu: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/FIRST_AGREEMENT_OF_PRINCIPLES_GOVERNING_THE_NORMALIZATION_OF_RELATIONS,_APRIL_19,_2013_BRUSSELS_en.pdf

79 ECMI Kosovë, 'Arsimi në gjuhën serbe dhe verifikimi i diplomave në Kosovë', nëntor 2018. Në dispozicion këtu: https://www.ecmikosovo.org/uploads/Brochure_Diploma_Verification_ALB.pdf

80 Rregullore (QRK) - nr. 21/2015 për Procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike (2016). Në dispozicion këtu: [http://kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_\(QRK\)_-_NR._212015_P%3C%8BR_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_P%3C%8BR_L%3C%8BSHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTET-ASVE_T%3C%8B_REPUBLIK%3C%8BS_5%3C%8BB_KOSOV%3C%8BS_T%3C%8BT_CIL%3C%8BT_KAN%3C%8BB_MARR.pdf](http://kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_(QRK)_-_NR._212015_P%3C%8BR_PROCEDURAT_DHE_KRITERET_P%3C%8BR_L%3C%8BSHIMIN_E_CERTIFIKATAVE_SHTET-ASVE_T%3C%8B_REPUBLIK%3C%8BS_5%3C%8BB_KOSOV%3C%8BS_T%3C%8BT_CIL%3C%8BT_KAN%3C%8BB_MARR.pdf)

filltë politik, të cilin ende nuk e kemi parë. Siç është sugjeruar nga Komisioni, institucionet përkatëse kosovare kanë mundur së paku të fillojnë të angazhohen *“në një dialog konstruktiv me punëtorët arsimorë dhe pedagogët e komunitetit shqiptar të Kosovës, komunitetit serb të Kosovës dhe nga komunitetet tjera në Kosovë për të gjeneruar ide dhe për t’i dhënë hov zhvillimit të planprogramit dhe teksteve mësimore mbi temat e historisë.”*⁸¹ Në anën tjetër, legjislati i Kosovës ofron një kornizë për përmbushjen e nevojave arsimore të nxënësve që vijnë në mësimet në shkollat serbe në një mënyrë më të koordinuar dhe të mbikëqyrur, d.m.th. duke paraqitur kërkesa për miratim të teksteve dhe materialeve të tjera mësimore.

MASHT-i gjithashtu duhet të zbatojë Objektivin Strategjik nr. 1 “Promovimi i diversitetit” të përfshirë në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021.⁸² MASHT-i dhe institucionet arsimore në nivelin lokal nuk kanë arritur të zhvillojnë mekanizma dhe politika gjithëpërfshirëse që promovojnë diversitetin⁸³ duke përfshirë modulet e veçanta të arsimit në komunitet sipas dispozitave të Ligjit për Komunitetet.⁸⁴

Pasi u arrit një marrëveshje ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit më 10 shtator 2015, sipas së cilës e para do të furnizojë me tekste mësimore komunitatet me shumicë shqiptare në jugun e Serbisë dhe e dyta do të furnizojë zyrtarisht institucionet arsimore të drejtuara nga serbët në Kosovë, autoritetet serbe ndaluan materialin mësimor në gjuhën shqipe nga Kosova për shkak të përmbajtjeve të njëanshme historike dhe politike⁸⁵ duke i mbajtur kamionët me materiale mësimore në pritje në terminalin doganor në Preshevë për gjashtë muaj.⁸⁶ Nga ana tjetër, Prishtina reagoi me masa reciprociteti dhe ndaloi hyrjen e teksteve mësimore nga Serbia pa miratimin e MASHT-it.

81 MASHT, “Komisioni i Pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe – raport gjithëpërfshirës”, 24 qershor 2010: f. 17. Në dispozicion këtu:

<http://archive.erisee.org/sites/default/files/-%20Comprehensive%20Report%20of%20Independent%20Commission%20for%20the%20review%20of%20serbian%20language%20teaching%20materials.pdf>

82 MASHT (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), Plan i Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021. Në dispozicion këtu: https://kryeministri.rks-gov.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NE_KOSOVE.pdf

83 KEEN (Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim). “Vlerësim afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021” nëntor 2019: 35. Në dispozicion këtu:

<http://kosovoprojects.eu/wp-content/uploads/2020/02/Implementation-of-Kosovo-Education-Strategic-Plan.pdf>

84 Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë, neni 8.7; dhe Konventa kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe raporti shpjegues, neni 6.1 dhe 12.

85 <https://balkaninsight.com/2015/12/10/no-end-in-sight-for-serbia-kosovo-textbooks-war-12-09-2015/>

86 <https://balkaninsight.com/2016/03/02/serbia-returns-kosovo-books-back-to-the-border-03-02-2016/>


Shumica e pjesëtarëve të **komunitetit goran** në territorin e Komunës së Dragashit vijojnë arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhën serbe, sipas planit dhe programit të Republikës së Serbisë. Procesi mësimor zhvillohet në disa shkolla fillore në zonat rurale dhe një shkollë të mesme në fshatin Mlikë, pas së cilit të diplomuarit në shumicën e rasteve regjistrohen në Universitetin e Mitrovicës Veriore, ndërsa një numër i vogël i tyre vazhdojnë arsimimin në gjuhën boshnjake në Universitetin e Prizrenit. Sfidat me të cilat përballen goranët në fillim të çdo viti shkollor janë të natyrës teknike, siç është dorëzimi i teksteve mësimore për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme nga Serbia, por edhe verifikimi i diplomës së shkollës së mesme të lartpërmendur nga institucionet e Kosovës. Shumë shpesh, maturantët nga Gora u skualifikuan nga institucionet e Kosovës në procesin e punësimit pikërisht për shkak të diplomave të tyre, sepse institucionet përkatëse të Kosovës e konsiderojnë atë si një sistem arsimor paralel. Në të kaluarën, ka pasur disa raste të diskriminimit me rastin e aplikimit për një vend pune në institucionet lokale, por edhe në Policinë e Kosovës. Ndërtesat shkollore dhe infrastruktura tjetër ku zhvillohet mësimi nuk janë në gjendjen më të mirë, por mirëmbajtja dhe financimi i tyre nuk bëhet në mënyrë transparente, ndonëse edhe Kosova edhe Serbia alokojnë mjete financiare për mirëmbajtjen e tyre. Edhe pse disa vite më parë në territorin e Komunës së Dragashit u ndërtua një godinë shkollore e cila mund të strehojë të gjithë nxënësit nga komuniteti goran, boshnjak dhe shqiptar dhe konsiderohet si një nga ndërtesat shkollore më moderne në Kosovë, Komuna e Dragashit dhe drejtoria e shkollës së mesme të lartpërmendur ende nuk kanë gjetur një model sipas të cilit procesi mësimor në atë ndërtesë do të mund të zhvillohej pa pengesa.

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët vazhdojnë të përballen me varfëri të rëndë, përjashtim të thellë shoqëror dhe pengesa në ushtrimin e të drejtave të tyre themelore. Këto probleme ndikojnë në qasjen e tyre në arsim cilësor, që nga ana tjetër minon shanset e tyre për punësim dhe të ardhura, kushtet e banimit dhe statusin shëndetësor dhe kufizon aftësinë e tyre të përgjithshme për të shfrytëzuar potencialin e tyre të plotë. Andaj, përmirësimi i situatës arsimore të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve është një provë vendimtare për qeverinë e Kosovës për të shënuar përparim në përfshirjen e këtyre komuniteteve.

Numri i fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë që ndjekin arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë është rritur vazhdimisht në vitet e fundit, megjithatë, hendeuku në vijimin e shkollimit dhe në pjesëmarrje mbetet i lartë, siç konfirmohet nga Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë (MICS), e cila është kryer në vitet 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Ndërsa Tabela 1 më poshtë tregon se hendeuku në pjesëmarrje në shkollim në shkollat fillore (klasa IV) është mjaft i vogël, ndryshimi rritet dukshëm në klasat e larta të shkollës fillore dhe ato të ulëta të shkollës së mesme (klasat VI-VIII dhe I në shkollë të mesme) dhe në mënyrë të jashtëzakonshme në klasat e larta (klasat II-IV) të shkollës së mesme.

Cluster Survey (MISC), carried out in 2019-2020 by the Kosovo Agency of Statistics (KAS).



Për të adresuar pjesëmarrjen e ulët të fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë në arsimin e rregullt, organizatat e shoqërisë civile në Kosovë në bashkëpunim me agjencitë dhe donatorët ndërkombëtarë dhe me mbështetjen e agjencive ndërkombëtare kanë zhvilluar me sukses një program të mbështetjes për aktivitetet jashtëshkollore dhe detyrat e shtëpisë përmes Qendrave Mësimore, duke ulur me sukses shkallën e braktisjes së shkollimit të rregullt dhe duke rritur cilësinë e arsimit të fëmijëve që marrin pjesë në procesin mësimor. Megjithatë këto Qendra Mësimore mbeten me rëndësi kyçe për mbështetjen e arsimimit të këtyre komuniteteve, ekziston rreziku që ato të mbyllen si rezultat i dështimit të qeverisë për të alokuar fondet e nevojshme për funksionimin e tyre të vazhdueshëm.

Arsimimi në gjuhën turke zhvillohet nga arsimi parashkollor deri te studimet themelore. Republika e Turqisë gjithashtu ofron mundësi për ata që dëshirojnë të vazhdojnë arsimimin e tyre në nivelin universitar. Në këtë rast, Drejtoria për turqit jashtë vendit dhe komunitetet gjegjëse (YTB) ofron

mundësi bursash për studentët që dëshirojnë të studiojnë në Turqi. Trupi Këshillëdhënës i Republikës së Turqisë për arsimin në Kosovë ndihmon në zhvillimin dhe përmirësimin e arsimit në gjuhën turke në shkollat fillore dhe të mesme në Mamushë dhe Prizren.

Përkundër faktit se nuk ka të dhëna të sakta, ekspertët nga **komuniteti boshnjak** pohojnë se në vitet e fundit ka pasur një trend madje shumë të dukshëm të rënies së numrit të fëmijëve që vijnë në mësimet në gjuhën boshnjake. Pjesëtarët e këtij komuniteti kanë mundësinë të ndjekin mësimet në gjuhën boshnjake në të gjitha mjediset ku ata jetojnë (në shtatë komuna në të gjithë Kosovën) sipas plan-programit të Ministrisë së Arsimit të Kosovës. Kur bëhet fjalë për arsimin e mesëm, nxënësit e shkollave të mesme nga ky komunitet vijnë në mësimet në shkollat e mesme në komunat e Prizrenit, Pejës dhe Dragashit, në paralele të ndara në gjuhën boshnjake që u formuan në mjediset me një numër më të vogël të pjesëtarëve të këtij komuniteti. Përveç kësaj, në Universitetin e Prizrenit dhe të Pejës janë krijuar drejtime në gjuhën boshnjake. Sipas qytetarëve të kombësisë boshnjake, qasja në arsim për këtë komunitet është në një nivel të kënaqshëm, por është shqetësuese neglizhenca e institucioneve në lidhje me numrin e konsiderueshëm të problemeve në programin mësimor në gjuhën boshnjake, mangësitë e të cilit ishin më të dukshme gjatë pandemisë.

Arsimi në komunitetet e cënueshme / komunitetet e izoluar

Shumica e popullatës lokale në komunitetet e izoluar jeton në një distancë të shkurtër nga kopshtet, shkollat fillore dhe / ose të mesme. Kjo është e vërtetë edhe për vendbanimet e populluara rrallë siç janë Gorazhdec, Osojani dhe Rahoveci, ndërsa të gjithë mund të mburren me objektet e arsimit fillor dhe të mesëm. Institucionet arsimore mbështeten ekskluzivisht nga Qeveria e Republikës së Serbisë, ndërsa pjesëmarrësit në hulumtim vunë re se ka vetëm një bashkëpunim shumë të kufizuar me shkollat ose institucionet që veprojnë nën kornizën ligjore të Kosovës.⁸⁷

Në këtë drejtim, dhe përkundër pranisë fizike të institucioneve arsimore, shumë ende vuajnë nga mungesa e fondeve, kushtet e këqija dhe vështirësitë në punësimin e mësimeve, shumë prej të cilëve sillen dhe udhëtojnë nga komuna më të mëdha, si Mitrovica e Veriut ose Graçanica.⁸⁸ Shumë prej të intervistuarve gjithashtu shprehën shqetësim në lidhje

87 Intervistat e kryera në terren në Kosovën lindore në shkurt dhe mars të vitit 2021.

88 Po aty

me ndikimin e migrimit dhe rënies së numrit të popullsisë në aftësinë e shkollave për të punuar, pasi numri i nxënësve të rinj shpesh është shumë poshtë mesatares kombëtare.⁸⁹ Për më tepër, mësimdhënësit gjithashtu vunë re mungesën e furnizimeve dhe gjendjen fizike ndonjëherë të dobët të ndërtesave ku janë të vendosura shkollat. Përkundër këtyre sfidave, shkollat shpesh kanë staf të përkushtuar dhe vazhdojnë të funksionojnë edhe në rrethana të vështira sociale dhe ekonomike.

Energjia elektrike

Një nga problemet kryesore me të cilat u përballën **pjesëtarët e komunitetit goran** gjatë vitit 2020 ishte mungesa e furnizimit të rregullt me energji elektrike. Dragashi, si komunë me një numër të konsiderueshëm të goranëve, nuk arriti të sigurojë furnizim të rregullt me energji elektrike, përkundër faktit se, siç theksohet nga përfaqësuesit dhe aktivistët nga ky komunitet, pjesëtarët e tij janë ndër paguesit më të rregullt dhe nuk kanë borxhe të prapambetura. Problemi me furnizimin preku veçanërisht goranët të cilët jetojnë në vendbanime të largëta rurale, ku qasja në energji elektrike u pamundësua në disa pjesë të caktuara të vitit, madje për disa ditë me radhë. Duke marrë parasysh specifikat gjeografike, motin dhe karakteristikat e infrastrukturës rrugore të Komunës së Dragashit (veçanërisht në zonat e banuara nga goranët), ndërprerja periodike e energjisë elektrike në vendbanimet e largëta praktikisht ka shkaktuar izolim shtesë dhe shkëputje nga pjesa tjetër e botës. Si pasojë e drejtpërdrejtë e këtij problemi, një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të këtij komuniteti dhe i familjeve të tyre pësuan dëme të konsiderueshme materiale. Edhe pse përfaqësuesit e goranëve vazhdimisht kanë tërhequr vëmendjen e institucioneve lokale dhe qendrore për këtë problem, e vetmja përgjigje që morën ishte se ky problem aktualisht është i pazgjidhshëm për shkak të, siç është thënë nga dega lokale e distribuimit të energjisë elektrike, rrjetit të konsumuar dhe të vjetruar të energjisë elektrike në këtë pjesë e Kosovës. Përkundër apeleve të shpeshta, mungesa e furnizimit të rregullt me energji mbetet një pengesë e pakapërcyeshme për komunitetin goran.

Kur bëhet fjalë për **komunitetin serb**, përdoruesit e shërbimeve të KEK-ut (*Korporata Energjetike e Kosovës*) që jetojnë në jug të lumit Ibër nuk janë përballur me probleme si ato në radhët e goranëve. Mirëpo, sipas pre-

tendimeve të vendasve, përkundër faktit që ata rregullisht shlyejnë detyrimet e veta, ata herë pas here marrin fatura që përmbajnë borxhe të cilat pretendohet se (më parë) ishin anuluar për shkak të një marrëveshjeje të lidhur me paguesit e rregullt.⁹⁰ Përkundrazi, një pjesë e qytetarëve të katër komunave veriore nuk shlyejnë borxhet e veta dhe nuk paguajnë faturat e energjisë elektrike, gjë që është temë e paralajmërimeve të shumta vite me radhë për ndërprerjen e kësaj praktike, gjë që, hë për hë, nuk ka rezultate praktike në terren. Situatën e ndërlikoi më tej për nga aspekti politik, por edhe ai energjetik, fakti që nga mesi i dhjetorit 2020, Serbia ndërpreu transmetimin e energjisë elektrike në Kosovë.⁹¹

Sistemi bankar dhe telekomunikimet

Megjithëse *Ligji për Përdorimin e Gjuhëve* zbatohet teorikisht për çdo kompani private që ofron “shërbime me rëndësi publike”, zbatimi i tij në këtë fushë është dukshëm më i dobët sesa në sektorin publik.⁹² Klientët që nuk flasin shqip shpesh raportojnë se nuk janë në gjendje të përdorin shërbimet bankare në gjuhën e tyre amtare (online, personalisht ose në ndonjë mënyrë tjetër) dhe janë të detyruar të nënshkruajnë kontrata ligjërisht detyruese pa ofrimin e përkthimit në gjuhën e tyre amtare. Megjithëse kjo shpesh mund të varet nga banka në fjalë, problemi duket se është i përhapur dhe klientët shpesh mbështeten në shpjegime joformale (me gojë) të kontratave dhe dokumenteve të tjera në lidhje me hapjen, mbylljen ose menaxhimin e një llogarie bankare.⁹³

Pjesëmarrësit e hulumtimit në zonat jashtë komunave me shumicë serbe mbështeten në shërbimet e ofruara nga bankat në komunat me shumicë shqiptare, duke çuar në situata ku ata nuk janë në gjendje të kuptojnë specifikat teknike të raportit të punës me këto institucione. Një serb i Kosovës nga Peja përmbloodhi përvojën e tij, duke thënë: *“Kur shkova në bankë për të provuar të hapja një llogari, personi me të cilin fola dinte vetëm shqip dhe anglisht dhe më ofroi vetëm një kontratë në gjuhën shqipe, unë kisha nevojë për atë llogari, por në të vërtetë nuk kisha ide se çfarë po nënshkruaja.”*⁹⁴ Megjithëse shumë banka më të mëdha kanë

90 BBC, *Jeta në Kosovë: Kush paguan faturat për shërbime komunale*, 2021, në dispozicion këtu:

<https://www.bbc.com/serbian/lat/balkan-55677677>

91 <https://www.slobodnaevropa.org/a/srbija-prekinula-prenos-elektricne-energije-na-kosovo/31002604.html>

92 Bazuar në hulumtimet në terren dhe intervistat e kryera me përfaqësuesit e sektorit bankar në shkurt dhe mars 2021.

93 Po aty

94 Intervistë e zhvilluar me banorin e një komune me shumicë serbe në jug të lumit Ibër në mars të vitit 2021.

degë në rajonet me shumicë serbe, stafi i tyre që flet gjuhën serbe raporton se shabllonët që ata marrin për kontrata dhe dokumente të tjera zyrtare janë ekskluzivisht në gjuhën shqipe, me vetëm ofrimin e përkthimeve ad hoc, që do të thotë se atyre u kërkohet të detyrojnë klientët ose klientët e mundshëm të lidhin marrëveshje kontraktuese përkundër mungesës së përkthimit.⁹⁵

Probleme të ngjashme ekzistojnë në sektorin e telekomunikimeve dhe ndërsa shumë operatorë kryesorë (me fjalë tjera IPKO dhe Vala) ofrojnë mundësi regjistrimi për njoftime SMS dhe shërbime të tjera të ngjashme në gjuhën serbe, kontratat e telefonisë celulare shpesh janë në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe dhe / ose angleze. Në këtë kuptim, problemi është i ngjashëm për nga natyra me problemin që haset në sektorin bankar. Një pjesëtar i komunitetit serb të Kosovës në Komunën e Pejës raportoi nënshkrimin e një kontrate për telefon celular me pagesë në shqip, ndërsa përfaqësuesi i operatorit celular nuk kishte arritur të shpjegonte dispozitat e kontratës, duke rezultuar në një situatë ku individ i në fjalë u përball me pagesa shtesë për shërbime të cilat ai nuk i kishte dashur.⁹⁶

Në nivelin lokal, **pjesëtarët e komunitetit goran** përballen me problemin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga degët e bankave që kryejnë veprimtarinë e tyre në Komunën e Dragashit. Pjesëtarët e këtij komuniteti, dhe më shpesh pensionistët, ankohen se nuk mund të marrin shërbime adekuat në ato banka, sepse shumica e nëpunësve bankarë nuk flasin gjuhën gorane ose serbe, por vetëm shqip, kështu që ata kanë shumë vështirësi për t'u marrë vesh. Përkundër faktit se sektori bankar është pjesë e sektorit privat, sipas ekspertëve të intervistuar, në Kosovë nuk ka mirëkuptim nga ana e menaxherëve të bankave që do të duhej të punësohen pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë, të cilët rrjedhimisht do të ofronin shërbime pa kurrfarë vështirësish.

Targat e regjistrimit KS (liria e lëvizjes)

Targat “KS” lëshohen që nga viti 2011 si një zgjidhje e përkohshme për lirinë e kufizuar të lëvizjes së komunitetit serb të Kosovës në Kosovë, si dhe për udhëtimet nga Kosova për në (ose përmes) Serbisë. Bazuar në *Marrëveshjen për finalizimin e zbatimit të Marrëveshjes për lirinë e lëvizjes të*

⁹⁵ Nga intervistat e zhvilluara me banorët serbë të Kosovës në komunat në jug të lumit Ibër në mars të vitit 2021.

⁹⁶ Intervistë e zhvilluar me banorin e Komunës së Pejës në mars 2021.

arritur dhe të nënshkruar nga Prishtina dhe Beogradi në Bruksel më 14 shtator 2016, Kosova mori përsipër detyrimin për të zgatur vlefshmërinë e targave KS për një periudhë pesëvjeçare. E njëjta marrëveshje kërkonte që nënshkruesit të rishikonin këtë çështje pas 14 shtatorit 2021, nën mbikëqyrjen dhe ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Përkundër detyrimeve të përcaktuara qartë sipas Marrëveshjes, Ministria e Brendshme e Kosovës megjithatë njoftoi në mes të shtatorit që: “Në përputhje me procedurën për zgjatjen e regjistrimit (të automjeteve) dhe në bazë të Vendimit nr. 2020, të gjithë pronarët e automjeteve që përdorin targat KS janë të detyruar që, pas skadimit të tyre, të zëvendësojnë targat KS me targat RKS.” Kjo procedurë e re paraqiste shkelje të drejtpërdrejtë të detyrimeve kontraktuese dhe rrezikoi të drejtat e shoferëve për marrjen ose zgjatjen e afatit të targave me shenjë KS. Me këtë vendim iu kufizua e drejta e lirisë së lëvizjes serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera jo-shumicë, si komuniteteve për të cilat zotërimi i targave KS është me rëndësi të madhe, veçanërisht për shkak të lidhjes së tyre me Serbinë. Për të njëjtat arsye ose për arsye të krahasueshme, në mënyrë të ngjashme u rrezikua lëvizja e shqiptarëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera mes Kosovës dhe Serbisë.

Ky vendim ishte problematik sepse u mor pa konsultuar komunitetin e gjerë ose profesionistët, gjë që i vendosi pronarët e targave KS para *aktit të kryer*. Për më tepër, mungesa e reagimit me kohë të ndërmjetësit (në këtë rast të Bashkimit Evropian) që përndryshe do të mund të ishte me përfitim për ata që preken nga vendimi, si dhe pasiviteti i Beogradit në lidhje me këtë veprim të njëanshëm, kontribuan në faktin që ky problem të lihet mënjanë. Për më tepër, procesi i marrjes së targave të reja RKS (pas kthimit të targave të vjetra KS) përfshinte një periudhë të (pa)aktuar të përdorimit të të ashtuquajturave *targa provuese*, me të cilat pronarët e automjeteve nuk lejohet të udhëtojnë jashtë Kosovës. Ministria e Brendshme nuk ishte në gjendje të lëshojë targa të reja RKS brenda kohës së duhur, duke penguar kështu drejtpërdrejt lirinë e lëvizjes dhe tregtisë për një numër të konsiderueshëm të individëve në të gjithë Kosovën.

Përkundër reagimit domethënës të OSHC-ve të serbëve të Kosovës dhe vëmendjes së medieve, institucionet përkatëse nuk dolën me reagime ose deklarata zyrtare.⁹⁷ OJQ AKTIV ka kuptuar se shumica e pronarëve

97 KosSev, OJQ: Qeveria kosovare të vazhdojë me lëshimin e targave të regjistrimit “KS” të paktën deri në shtator 2021, 2020, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/nvo-kosovska-vlada-da-nastavi-da-izdaje-ks-registarske-oznake-bar-do-septembra-2021/>

të targave *KS* nuk ishin informuar në mënyrë të rregullt për vendimin e sipërpërmendur. Mungesa e një qasjeje të përshtatshme për informimin e qytetarëve në lidhje me vendimin e ri nga ana e institucioneve krijoi një konfuzion të gjerë.

Me rigjallërimin dhe rinisjen pasuese të bisedimeve mes Prishtinës dhe Beogradit, ishte me rëndësi shumë të madhe që të dy palët të mbështesnin parimet që tashmë janë rënë dakord. Në praktikë, kjo do të nënkuptonte se Ministria e Brendshme do të duhej të shfuqizonte vendimin dhe të koordinonte të gjitha ndryshimet në aranzhimin ekzistues me Brukselin dhe Beogradin, siç kërkohet nga vetë marrëveshja. Pronarët e automjeteve me targa *KS* u diskriminuan drejtpërdrejt nga një vendim i Ministrisë dhe nuk kishin qasje në mekanizma dhe / ose të drejtën e ankimit.

Qasja në dokumente dhe shtetësia

Guri kryesor themeltar i projektit të ndërtimit të shtetit në Kosovë në periudhën jo aq të largët ishte përpjekja për të garantuar zbatimin e plotë dhe të papenguar të kornizës ligjore dhe kushtetuese të Kosovës dhe krijimin e mirëfilltë të sistemeve të qeverisjes dhe strukturave institucionale të afta për t'iu përgjigjur në mënyrë efikase nevojave të qytetarëve dhe të cilat kultivojnë një hapësirë që mundëson rrënjosjen e sundimit të ligjit.

Ky qëllim mjaft i lartë është goditur nga një sërë problemesh që janë rezultat i drejtpërdrejtë i një konteksti kompleks historik dhe politik, plot e përplot me tensione ndëretnike ende të pazgjidhura. Përkundër vullnetit të mirë të dukshëm të aktorëve ndërkombëtarë dhe elitës politike, vetë qeveria e Kosovës në të kaluarën e ka njohur madhësinë dhe shtrirjen e problemit në fjalë. Ajo veçanërisht ka theksuar kompleksitetin e vendosjes së sundimit të plotë të ligjit në Kosovë që nga ndërprerja e armiqësive në fillim të viteve 2000.⁹⁸ Për më tepër, zbatimi i akteve ligjore, akteve normative dhe vetë kushtetutës është shpërndarë në rastin më të mirë në mënyrë të pabarabartë mes shtresave të ndryshme të qeverisjes, fakt që Bashkimi Evropian dhe misionet e tjera të pranishme në Kosovë e kanë njohur shumë herë.⁹⁹

98 Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë 2016–2019, e punuar nga Qeveria e Kosovës, f. 7.

99 Dokument pune i personelit të Komisionit: Raport për Kosovën 2018, Strasburg, korrik 2018, f. 6.

Një nga çështjet më të shquara me të cilat është përballur Qeveria e Kosovës ishte krijimi i një sistemi institucional të aftë për të zbatuar ligjet në lidhje me mbrojtjen e grupeve dhe komuniteteve pakicë. Megjithëse fush-ëveprimi i gjithmbarshëm i ligjeve për të drejtat e jo-shumicës është i gjerë dhe jo të gjitha ligjet medoemos duhet të ndikojnë në jetën e përditshme të pjesëtarëve të komuniteteve, ka probleme që për shumë qytetarë kanë vështirësuar rëndë qasjen e plotë në të drejtat ligjore dhe kushtetuese. Kryesor mes tyre ishte problemi i qasjes në dokumente personale, problem ky për të cilin ende nuk është gjetur një zgjidhje afatgjatë dhe e qëndrueshme.

Në përgjithësi, ky problem ka këto dimensione kryesore:

- › Fakti që deri në gusht 2018, Qeveria e Kosovës i trajtonte të gjitha format e dokumentacionit të lëshuara nga institucionet (paralele) serbe në Kosovë si jo-legjitime;
- › Serbët nga Kosova me dokumente të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e gjetën veten në një situatë ku institucionet dhe qeveria e Kosovës i konsideronin dokumentet e tyre të udhëtimit dhe personale të pavlefshme dhe të paligjshme, përkundër faktit se kjo nuk kishte asnjë bazë ligjore;
- › Personat e Zhvendosur Intern (PZHI) dhe ata të lindur pas vitit 1999, veçanërisht në veri të Kosovës, janë përballur dhe vazhdojnë të përballen me sfida në marrjen e shtetësisë dhe dokumenteve të shtetësisë së Kosovës.

Para gushtit 2018,¹⁰⁰ institucionet dhe organet administrative në Kosovë nuk i kanë pranuar (në praktikë, por jo edhe sipas ligjit) dokumentet personale të lëshuara nga disa institucione “paralele”, si dëshmi e vendqëndrimit dhe / ose e të drejtës së shtetësisë. Siç thuhet në kontributet e organizatës joqeveritare AKTIV parashtruar Bashkimit Evropian nga janari 2018: Një arsye ose bazë e mundshme për këtë duket të ketë qenë një deklaratë me gojë e bërë në vitin 2016 nga Edita Tahiri^{101, 102} ku ajo ka deklaruar se çfarëdo dhe çdo dokument i lëshuar për serbët që jetojnë në Kosovë është i paligjshëm. Sidoqoftë, nuk kishte asnjë ligj ose urdhëresë dhe / ose udhëzim formal administrativ që përshkruante ose përcaktonte këtë praktikë. Kjo është akoma e pranishme në mesin e autoriteteve kosovare, posaçërisht

100 Kur Ministria e Brendshme lëshoi urdhëresën që institucionet kosovare të pranojnë dokumentet e lëshuara nga institucionet serbe në Kosovë si dëshmi të vendqëndrimit.

101 <http://prishtinainsight.com/kosovo-bans-usage-serbian-parallel-id-cards/>

102 <http://prishtinainsight.com/documented-yet-invalid-mag/>

zyrtarëve kufitarë dhe të doganave, që pasaportat ose dokumentet personale të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e Qeverisë së Serbisë të mos pranohen si të vlefshme për udhëtim ndërkombëtar. Zanafilla e kësaj praktike është përsëri e paqartë, por pavarësisht nga kjo, ajo seriozisht pengon lirinë e lëvizjes së të prekurve.

Kronologjia:

› Ministria e Brendshme lëshoi udhëzime me titullin *Udhëzime mbi kriteret që përbëjnë dëshmi të shtetësisë së RFJ-së dhe vendqëndrimit në territorin e Kosovës më 1 janar 1998*. Megjithëse ata u përpoqën të sqarojnë një sërë procedurash në procesin e aplikimit për shtetësinë e Kosovës, ata nuk theksuan nëse dokumentet e lëshuara nga institucionet paralele ishin ligjërish të vlefshme për të dëshmuar qëndrimin e përhershëm në territorin e Kosovës.

› Në korrik 2018, Ministria e Brendshme nxori një urdhëresë administrative ku thuhej se “të gjithë qytetarët e Kosovës” mund të aplikojnë për akte të regjistrimit civil (lindje, martesë dhe vdekje) duke përdorur dokumentet e lëshuara nga “strukturat serbe” në Kosovë.¹⁰³

Megjithëse disa nga këto ndryshime kishin një karakter pozitiv, kronologjia e sipërpërmendur hyri në fuqi në verën e vitit 2018 dhe skadoi në 2019. Nëse urdhëresa do të zgjatet apo jo është ende e pasigurt dhe e paqartë. Përveç kësaj, urdhëresa pranon vetëm dokumentet e lëshuara deri në vitin 2016 (në urdhëresë nuk jepet asnjë arsytim). Deri më tani, ka pak tregues se kjo ka përmirësuar ndjeshëm situatën për ata serbë (dhe pjesëtarët e tjerë të komuniteteve jo-shumicë) të cilët kanë pasur vështirësi lidhur me qasjen në dokumente të shtetësisë, pasi ky urdhër është bërë me njëfarë shkalle të fshehtësisë dhe, deri më sot, nuk është bërë përpjekje nga Qeveria e Kosovës për t’ua komunikuar ndryshimin serbëve të Kosovës ose komuniteteve të tjera jo-shumicë të prekura nga kjo. Në këtë drejtim, një sasi e caktuar e dëshmive anekdotike sugjerojnë që urdhëresa po zbatohet në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

Mbajtësit e pasaportave të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese për Kosovën dhe Metohinë (e cila vepron brenda sistemit të Republikës së Serbisë) përballen me një sërë problemesh në lidhje me lirinë e lëvizjes. Përkundër faktit se ata mund të udhëtojnë në një masë të kufizuar në

vende të caktuara në rajon, institucionet e Kosovës ende nuk e njohin këtë dokument udhëtimi dhe ai nuk mund të përdoret për të hyrë dhe dalë nga Kosova. Problemi thelbësor ka të bëjë me mos ekzistencën e një dokumenti zyrtar që rregullon përdorimin e këtyre pasaportave, gjë që përfaqësuesve të institucioneve u ofron hapësirë të mjaftueshme për manipulim dhe keqpërdorim. Ngjashmëria në këtë qasje mund të shihet edhe në trajtimin e pasaportave të Republikës së Serbisë me rastin e hyrjes në Kosovë, ku ato nuk njihen përkundër faktit se nuk ka asnjë udhëzim administrativ që e përcakton këtë dokument si jo-legjitim.

Gjatë hulumtimit të kryer si pjesë e mbledhjes së të dhënave për këtë raport, **pjesëtarët e komunitetit boshnjak** tërhoqën vëmendjen ndaj gabimeve administrative që ndodhin shpesh me rastin e lëshimit të dokumenteve personale. Gjegjesisht, Ministria e Brendshme, e cila është e ngarkuar me lëshimin e dokumenteve të identifikimit, në disa raste ka bërë gabime (jo) të qëllimshme kur janë futur të dhënat personale të pjesëtarëve të këtij komuniteti jo-shumicë. Gabimet më të zakonshme që janë vënë re ishin zëvendësimi i shkronjës origjinale ç në gjuhën boshnjake (zëvendësuar me shkronjën përkatëse në gjuhën shqipe - q) dhe regjistrimi i pasaktë i vendndodhjes / adresës së banimit në gjuhën shqipe (p.sh. Vitomiricë në vend të Vitomirica), në vend se në gjuhën amtare, gjë që në të vërtetë paraqet detyrim ligjor. Kur bëhet fjalë për lëshimin e pasaportave të Kosovës, numri i gabimeve të përmendura më parë në gjuhën boshnjake është shumë i rrallë, madje nuk ekziston. Në anën tjetër, boshnjakët e Kosovës, kur aplikojnë për dokumente personale dhe të tjera në situata të caktuara hasin probleme, kryesisht të natyrës gjuhësore, kur u drejtohen punonjësve në institucionet lokale dhe qendrore. Në këtë kuptim, në nivelin lokal ka dallime të konsiderueshme mes komunave ku boshnjakët përbëjnë një përpjesë të konsiderueshme të popullsisë së përgjithshme.

Qytetarët e kombësisë gorane gjithashtu theksuan raste të kohëpas-kohshme të gabimeve drejtshkrimore dhe gjuhësore në dokumentet personale, por këto raste kishin të bënin kryesisht me shënimin e vendbanimit në shqip. Ashtu si pjesëtarët e komunitetit boshnjak dhe serb, goranët në Kosovë kur u drejtohen institucioneve të nivelit qendror shpesh përballen me problemin e mungesës së punonjësve që flasin në gjuhën amtare të atyre që u drejtohen këtyre institucioneve. Mirëpo, sipas dëshmimeve të pjesëtarëve të komunitetit goran dhe boshnjak, nuk ka pasur pengesa të ndjeshme ose të vogla administrative në procesin e marrjes së dokumenteve në Kosovë. Nga ana tjetër, **pjesëtarët e komunitetit RAE** e shohin praktikën e rrënjësuar të trajtimit joadekuat nga institucionet lokale dhe qendrore si pengesën më të madhe për qasjen në dokumente. Ky problem bie nën një spektër më të gjerë të diskriminimit institucional

ndaj pjesëtarëve të komunitetit RAE, sipas ekspertëve të intervistuar nga ky komunitet. Krahas kësaj, një pengesë e shpeshtë për marrjen e dokumenteve është mungesa simptomatike e mjeteve monetare të nevojshme në procesin e aplikimit.

Sipas pretendimeve të qytetarëve dhe ekspertëve nga radhët e komunitetit turk, pjesëtarët e këtij komuniteti nuk hasin në pengesa kur aplikojnë për dokumente. Siç është theksuar në disa raste, të gjitha dokumentet e nevojshme mund të merren në nivelin qendror dhe lokal edhe në gjuhën turke, që për pjesëtarët e këtij komuniteti e bën shumë më të lehtë komunikimin me institucionet. Mirëpo, kur bëhet fjalë për komunikimin në gjuhën turke me zyrtarët në disa institucione të caktuara të nivelit qendror, ka shpesh raste kur ata nuk mund të ofrojnë shpjegime me gojë në lidhje me procedurat dhe kërkesat e qytetarëve gjuha amtare e të cilëve është turqishtja.

Vonesat në aplikimin dhe marrjen e dokumenteve personale gjatë vitit 2020 ishin një emërues i përbashkët i pengesave për të gjitha komunitetet në Kosovë, për shkak të punës së kufizuar të institucioneve gjatë pandemisë.¹⁰⁴

¹⁰⁴ Kosovo Online, *Qytetarët e Kosovës pa letërnjoftime deri në dhjetor, 2020*, në dispozicion këtu: <https://www.kosovo-online.com/vesti/drustvo/gradjani-kosova-bez-licnih-karata-do-decembra-8-10-2020>

IV.

Çështjet sociale dhe ekonomike

Siguria materiale

Megjithëse migrimi nga Serbia qendrore dhe republikat e tjera të ish-Jugosllavisë mbase nxitet në masë të madhe nga përkeqësimi i situatës ekonomike, shpërngulja e serbëve nga Kosova është e motivuar nga një sërë faktorësh. Trendet e përgjithshme demografike në mesin e serbëve të Kosovës tregojnë një rënie të përgjithësuar të popullsisë së përgjithshme, e cila mund t'i atribuohet kryesisht rrjedhës së vazhdueshme dhe të pandërprerë të migrantëve jashtë Kosovës. Megjithëse konflikti në fund të viteve 1990 ishte në shumë mënyra katalizatori për këtë rënie, mungesa rezultuese e mundësive të qëndrueshme ekonomike për përparim material dhe profesional do të thotë që për shumë të rinj serbë ka një mungesë të theksuar të perspektivave për të ardhmen. Këtu duhet të theksohet se treguesit ekonomikë në enklavat serbe në Kosovë nuk janë medoemos në mënyrë drastike më të këqij sesa në Kosovë në tërësi; një hulumtim i kryer nga Banka Botërore në 2017 e vuri papunësinë e të rinjve në një normë të zymtë prej 57%. Përkitazi me këtë, të dhënat e papunësisë për personat e zhvendosur intern në Kosovë janë astronomike; 69.5% raportuan se ishin të papunë dhe nuk kishin të ardhura të rregullta. Pjesëmarrësit në grupet e fokusit dhe në intervista shpesh ankoreshin për mungesën e mundësive të punësimit afatgjatë dhe të sigurt. Kjo është veçanërisht e vërtetë në komunitetet e serbëve të Kosovës në jug të lumit Ibër, ku të rinjtë në përgjithësi nuk e shohin një të ardhmen për veten.¹⁰⁵ Fshatrat më të vogla po përballen me një situatë të rënies graduale të popullsisë, kryesisht për shkak të largimit të pjesëtarëve më të rinj të komunitetit, gjë që pasqyrohet në deklaratën e një banori të fshatit Crkolez *“unë do të doja të qëndroj, por nëse dua të punoj, i vetmi opsion është të largohem”*.¹⁰⁶ Rezultat i kësaj është një numër i madh i fshatrave më të vogla të banuara pothuajse ekskluzivisht nga persona të moshuar, fëmijët e të cilëve qëmoti janë larguar në kërkim të një sigurie ekonomike më të madhe dhe afatgjatë.¹⁰⁷

Situata e rëndë ekonomike dhe materiale në shumë pjesë të Kosovës të populluara nga serbët ndërlikohet nga fakti se ata përballen me atë që mund të përshkruhet si një e ardhme e pasigurt politike, institucionale dhe kulturore në Kosovë. Brengat në lidhje me fatin e institucioneve serbe dhe aftësinë e tyre për të ofruar shërbime në sektorë të ndryshëm (shëndetësi, arsimi, mbrojtja sociale) duket se paraqesin shqetësim të veçantë, gjë

105 Bazuar në hulumtimin në terren të kryer në enklavat serbe në Kosovë në mars 2021.

106 Intervistë e zhvilluar me banorin e fshatit Crkolez në mars 2021.

107 Po aty

që ndërlikohet nga mungesa e besimit në sektorin publik të Kosovës për të siguruar një nivel adekuat të mbrojtjes sociale në komunitetin serb.¹⁰⁸ Shqetësimet për të ardhmen e organeve publike të financuara nga Qeveria e Republikës së Serbisë kanë një dimension të fortë ekonomik dhe mbizotëron ndjesia se largimi i tyre (potencial) do të çonte në një rënie të mirëqenies materiale të popullatës lokale, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se këto janë një burim i punësimit të besueshëm për shumë familje vendase. Për më tepër, ekziston pakënaqësia e përgjithshme me faktin se punësimi në sektorin publik, qoftë kosovar ose serb, është një nga burimet e pakta të punësimit afatgjatë. Ndonëse shumë pjesëmarrës në grupet e fokusit dhe në intervista deklaruan se ata preferojnë të qëndrojnë në komunitetet e tyre të tanishme, ata mendojnë se e ardhmja e pasigurt është motivi kryesor për dëshirën e tyre për t'u larguar. Kjo ndjenjë e pasigurisë materiale mbase përkeqëson përshtypjen se përfaqësuesit politikë dhe institucionet shtetërore nuk po ofrojnë shërbime të përshtatshme.

Qasja e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në vende të punës është e kufizuar për arsye të ndryshme - nivelet e ulëta të arsimimit, pengesat në tregun e punës, segregacioni dhe kushtet e këqija të jetesës. Kjo forcon varfërinë, e cila nga ana tjetër forcon nivelin e ulët arsimor dhe kushtet e papërshtatshme të jetesës, ndërsa të gjitha këto kontribuojnë në ciklin e vazhdueshëm të varfërisë me të cilin këto komunitete janë përballur në planin afatgjatë. Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët përbëjnë 2.07% të popullsisë së Kosovës, por pothuajse 10% e përfitimeve sociale shtetërore u ndahen pjesëtarëve të këtyre tri komuniteteve, gjë që tregon se në këtë komunitet shkalla e varfërisë është dukshëm më e lartë sesa në pjesën tjetër të shoqërisë. Pjesëmarrja e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në strukturat e punësimit në institucionet publike është dukshëm më e ulët se prania e tyre në popullsinë e përgjithshme, prandaj ka një numër në rritje të kërkesave drejtuar institucioneve për të krijuar kushtet për pjesëmarrje të barabartë të këtyre komuniteteve në institucionet publike si pjesë e kuotës prej 10% për punësim të pakicave.

Ajo që doli të jetë **problem i përbashkët mes pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë**, bazuar në hulumtimet e kryera nga OJQ AKTIV, është se problemi i ashtuquajtur ikja e trurit është bërë një çështje e ngutshme. Ekspertët e intervistuar gjatë aktiviteteve hulumtuese theksuan se gjendja e dobët financiare dhe mungesa e punësimit në mesin e të rinjve të

108 Bazuar në hulumtimin në terren të kryer në enklavat serbe në Kosovë në mars 2021.

arsimuar nga këto komunitete kanë bërë që ata të vendosin të kërkojnë mundësi të reja dhe punësim jashtë Kosovës. Ky është gjithashtu rasti me ata që nuk kanë arsimim formal dhe që e kanë gjetur veten në një situatë ku migrimi në vendet më të zhvilluara është bërë e vetmja zgjidhje e qëndrueshme për problemet e tyre financiare dhe materiale.

Prona

Zgjidhja e marrëdhënieve pasurore-juridike dhe problemi i pronës së uzurpuar është akoma çështje aktuale njëzet vjet pas konfliktit. Përkundër ndihmës së konsiderueshme financiare dhe logjistike të ofruar për procesin e zgjidhjes së problemeve nga aktorët ndërkombëtarë, si dhe angazhimin e institucioneve qendrore dhe vendore, e drejta për paprekshmërinë e pronës private bie në fushën e sfidave për të cilat zgjidhja përfundimtare nuk shihet në horizont. Megjithëse gjatë dialogut teknik mes Prishtinës dhe Beogradit u dakorduan bazat dhe u përcaktuan parimet e trajtimit të problemit të një numri të madh të marrëdhënieve pasurore-juridike të pa përkufizuara në Kosovë, nuk është vërejtur asnjë përparim thelbësor që nga nënshkrimi i marrëveshjes për shkëmbimin e librave kadastrorë (2011). Për më tepër, me marrëveshje u ra dakord për themelimin e Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), gjegjësisht organit që duhej të angazhohej institucionalisht për zgjidhjen e këtij problemi, por që praktikisht u bë funksional vetëm në vitin 2016. Përveç faktit që procesi i shkëmbimit të kopjeve të librave kadastrorë iu nënshtrua obstruksioneve, përkufizimi i paqartë i kornizës normative dhe kompetencave të AKKVP-së penguan më tej përshejtimin e procesit të përcaktimit përfundimtar të pronësisë mbi pronën e personave të zhvendosur.

Ndërkohë, proceset gjyqësore të filluara në gjykatat lokale ku qytetarët kërkonin kthimin e pronave dhe / ose vërtetimin e pronësisë mbi to, ranë viktimë e vonësive të shpeshta, mungesës së përkthimit në gjuhët amtare të palëve dhe pengesave administrative dhe burokratike. Kostoja e lartë financiare e pjesëmarrjes në procedime gjyqësore ka parandaluar shumë pretendues të realizojnë drejtësinë e dëshiruar prej kohësh lidhur me të drejtat e tyre pronësore. Drejt këtij synimi, ata u parandaluan në mënyrë të konsiderueshme nga kostot e transportit, pagesat e avokatëve dhe taksat administrative gjyqësore. Pavarësisht nga mundësia e kërimit të ndihmës juridike falas, ngarkesa e avokatëve me një numër të madh çështjesh aktive në gjykatat lokale është bërë një nga sfidat kyçe për palët e interesuara. Gjithashtu, distanca kohore nga momenti i braktisjes së shtëpisë pas konfliktit, la pronarët e moshës më të vjetër pa ndihmë / asistencë të drejtpërdrejtë në procesin e nisjes (ose vazhdimin) të vërtetimit të pronësisë mbi pronën.

Zgjidhja e këtij problemi ndërlikohet më tej nga numri i konsiderueshëm i objekteve të dëmtuara në pronësi të personave të zhvendosur, të cilët përveç mbështetjes financiare për pjesëmarrje në proceset gjyqësore, kanë nevojë edhe për mbështetje për rinovimin e objekteve. Megjithatë misionet ndërkombëtare me ndërmjetësimin e Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit kanë ndihmuar në rinovimin e një numri të konsiderueshëm të shtëpive të të kthyerve në të gjithë Kosovën, këto raste në përgjithësi nuk kanë qenë lëndë e proceseve gjyqësore që kishin për synim vërtetimin e të drejtave pronësore. Bazuar në të dhënat në dispozicion të AKKVP-së, janë identifikuar gjithsej 42,749 raste të pronës së uzurpuar, nga të cilat 12,823 lëndë janë aktualisht nën juridiksionin e kësaj agjencie. Në vitet e fundit, është vënë re një përparim i ndjeshëm në procesin e zgjidhjes së rasteve individuale nën menaxhimin e AKKVP-së. Mirëpo, një pjesë e konsiderueshme e rasteve të përfunduara janë edhe ato ku kontesti është zgjidhur duke ia shitur pronën personave që ndërkohë kanë uzurpuar pronën. Sidoqoftë, pavarësisht nga të gjitha mangësitë e përmendura që mund të kapërcehen, përgjegjësia më e madhe mbetet te institucionet kompetente të cilat, përkundër kufizimeve objektive, ende nuk tregojnë interesim dhe vullnet të mjaftueshëm për të kapërcyer *status quo*-në e pjesshme aktuale në progresin drejt zgjidhjes së çështjeve pasurore-juridike.

Procesi i kthimit

Procesi i kthimit të personave të zhvendosur pas konfliktit në Kosovë ka shkuar ngadalë dhe ishte i ngarkuar nga ndikimet e politikës së përditshme dhe narrativat nacionaliste. Përkundër mbështetjes së konsiderueshme financiare dhe logjistike nga bashkësia ndërkombëtare, si dhe institucionet lokale dhe qendrore, numri i komuniteteve jo-shumicë që janë kthyer në Kosovë është pothuajse i papërfillshëm. Një faktor kyç që ka ndikuar në procesin e ngadaltë të kthimit të personave të zhvendosur, veçanërisht në pjesën perëndimore të Kosovës, është mjedisi i paqëndrueshëm i sigurisë dhe mbështetja e brishtë institucionale dhe administrative për të kthyerit. Sulmet e shpeshta fizike dhe ndaj pronës, si dhe rezistenca e popullatës lokale ndaj të kthyerve, gjatë dy dekadave të fundit kanë demotivuar ata që kanë shprehur dëshirën për t'u kthyer dhe për të krijuar një jetë normale / të qëndrueshme në Kosovë. Marrëdhëniet e pazgjidhura pasurore-juridike, si dhe rastet e shpeshta të uzurpimit të pronës së personave të zhvendosur, shpesh shoqërohen me një reagim joadekuat të institucioneve kompetente. Për më tepër, liria e kufizuar e lëvizjes dhe qasja e kufizuar në shërbime kanë pamundësuar më tej rritjen e konsiderueshme të numrit të personave që kthehen në Kosovë. Në rrethana të tilla, rënia e numrit të kthimeve në Kosovë është pasojë e drejtpërdrejtë e fakteve të lartpërmendura.

Sipas të dhënave nga OSBE-ja¹⁰⁹ dhe nga Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit,¹¹⁰ nga viti 1999 deri në fund të vitit 2018, nga gjithsej 220,000 / 226,400 persona të zhvendosur (jo-shqiptarë), 28,110 / 28,000 u kthyen në Kosovë. Numri i të kthyerve, veçanërisht në dekadën e fundit, ka qenë në rënje, kështu që në periudhën mes 2015 dhe 2019 ishte si më poshtë:

- › viti 2015: 802 të kthyer,
- › viti 2016: 582 të kthyer,
- › viti 2017: 498 të kthyer,
- › viti 2018: 327 të kthyer,
- › viti 2019: 115 të kthyer.

Krahasuar me shifrën e vitit 2006 prej 1,608, të dhënat e mësipërme mbështesin pohimin se numri i kthimeve në Kosovë po bie në mënyrë eksponenciale. Pavarësisht nga rrethanat kufizuese dhe vështirësitë e shkaktuara nga pandemia e virusit COVID-19, në vitin 2020 u kthyen 273 individë.¹¹¹ Sidoqoftë, kjo shifër gjithashtu tregon një praktikë tashmë të rrënjësor. Nga numri i përgjithshëm i të kthyerve, shumica ishin nga komuniteti serb, pasuar nga egjiptianët, romët dhe ashkalinjtë. Viteve të fundit, serbët e kthyer janë kthyer kryesisht në komunat me shumicë serbe (Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Shtërpçë, Novo Bërdë dhe Ranilug), ndërsa gjatë këtij procesi, pjesëtarët e komunitetit RAE janë kthyer në mjediset ku ata kanë jetuar tradicionalisht. Një rritje e konsiderueshme në numrin e të kthyerve në shtatë vitet e fundit është vërejtur edhe në komunat Gjilan, Obiliq, Istog dhe Klinë. Sidoqoftë, kthimi në mjediset urbane/ qytete në Kosovë praktikisht nuk ka ekzistuar që nga fillimi i procesit, gjë që ka kufizuar dukshëm efektet e integritit të komunitetit serb në sistemin dhe shoqërinë kosovare në tërësi.

Bazuar në pohimet e të kthyerve të intervistuar, situata aktuale nuk ngjall shpresë pozitive për përmirësimin e kushteve për jetesën e tyre të sigurt dhe të qëndrueshme. Siç theksoi një nga të kthyerit në një fshat në perëndim të Kosovës, i cili ka shtatë vjet që jeton dhe punon në pronën e tij të rinovuar, pasiguria institucionale dhe e mbrojtjes mbeten pengesat kryesore për jetën normale. Kur këtu shtohen kushtet e këqija infrastrukturore në mjediset e të kthyerve, si dhe gjendjen materiale dhe financiare të palakmueshme të vazhdueshme në mesin e qytetarëve të kthyer, i gjithë procesi i kthimit është vënë seriozisht në mëdyshje.

109 <https://www.osce.org/files/f/documents/d/f/440741.pdf>

110 <https://www.slobodnaevropa.org/a/kosovo-raseljeni-vratili-se-pa-brzo-otisli/30743454.html>

111 <http://radiomitrovica.sever.com/2020/12/30/ministar-jevtic-u-2020-povratak-na-porazavajucom-nivou-273-povratnika-i-62-incidenta-u-kojima-su-oni-zrtve/>

V.

Identiteti dhe trashëgimia kulturore

Mbrojtja e objekteve të trashëgimisë kulturore (d.m.th. KOS)

Në vitin 2017, Qeveria e Kosovës adoptoi të shumëpriturën Strategji Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore¹¹² e cila është aktualisht dokumenti i vetëm qeveritar që përmend shprehimisht “diskrecionin e plotë” të Kishës Ortodokse Serbe (KOS) *“në menaxhimin dhe qasjen në pronat e saj kulturore, përfshirë konservimin dhe restaurimin e monumenteve në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe duke vepruar në përputhje me ligjet e Kosovës.”*¹¹³

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore të të gjitha komuniteteve është në interesin e përgjithshëm të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ruajtja e trashëgimisë kulturore nënkupton mbajtjen dhe përmirësimin e vlerës së saj, por edhe vënien e këtyre vlerave në dispozicion të të gjitha komuniteteve në Kosovë. Një gjë që thekson gjithashtu nevojën për të mbrojtur trashëgiminë kulturore është fakti që komunitetet gjithashtu mund të përfitojnë ekonomikisht nga promovimi dhe mbrojtja e saj. Për më tepër, mbrojtja dhe rehabilitimi i trashëgimisë kulturore të Kosovës mund të luajnë rol kyç në nxitjen e pajtimit dhe dialogut ndëretnik.

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) është përgjegjës për menaxhimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Ai menaxhon punën e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM) dhe gjashtë Qendrave Rajonale për Trashëgiminë Kulturore (QRTK) në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjiilan, të cilat janë të ngarkuara me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale. Në nivelin komunal, drejtori i Drejtorisë për Kulturë, duke përfshirë trashëgiminë kulturore, raporton në QRTK-në përkatëse, si dhe në MKRS në nivelin qendror. Tutje, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK), organ këshillimor i Kuvendit të Kosovës, ndër të tjera, ka mandat për të miratuar Listën e Trashëgimisë Kulturore, duke mbështetur mbrojtjen, ruajtjen dhe menaxhimin e saj.

Përveç kësaj, Departamenti i Planifikimit Hapësinor dhe Instituti për Planifikim Hapësinor në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) janë të angazhuar në mbrojtjen e Zonave të Veçanta të Mbrojtura (ZVM) dhe sigurojnë që planet hapësinore për zonat brenda ZVM-ve të jenë në përputhje me ligjet që i rregullojnë ato.

112 https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/shqip_strategjia_per_trashegimi.pdf

113 Po aty, f. 31.

Këshilli Zbatues dhe Monitorues (KZM) është një organ i veçantë, puna e të cilit filloi në qershor 2010, i ngarkuar me monitorimin dhe lehtësimin e zbatimit të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, ndër të tjera, duke lehtësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes KOS dhe autoriteteve qendrore dhe lokale.¹¹⁴ Bazuar në Udhëzimin Administrativ të MMPH nga viti 2013,¹¹⁵ Këshilli aktualisht ka pesë anëtarë: Ministri i MMPH, Ministri i MKRS, KOS në Kosovë, Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-së (EUSR) në Kosovë dhe Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, ndërsa bashkë-kryesohet nga MMPH dhe EUSR.¹¹⁶

Siç është raportuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, MKRS-ja ka iniciuar listën e bazave të të dhënave të trashëgimisë kulturore, deri në vitin 2014, me 200 nga 1,441 monumente të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme¹¹⁷ në përputhje me detyrimin ligjor që del nga Ligji për Trashëgiminë Kulturore.¹¹⁸ Në vitin 2016, Ministria nxori një vendim me listën që përfshinte 23 asete të trashëgimisë kulturore që tani janë nën mbrojtje të përhershme, megjithëse vendimi u botua vetëm në gjuhën shqipe.¹¹⁹ Në kohën e shkrimit të këtij raporti, në uebsajtin zyrtar të Ministrisë në gjuhën shqipe është publikuar në mënyrë të rregullt vendimi mbi asetet e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme¹²⁰ me listën përkatëse,¹²¹ ndërsa versioni i uebsajtit në gjuhën serbe ofron vetëm listën e përkthyer në gjuhën serbe.¹²² Mirëpo, sipas ligjit nuk është saktësuar se cili institucion është përgjegjës për identifikimin dhe inventarizimin e trashëgimisë kulturore,¹²³ proces ky në të cilin institucionet përkatëse të Kosovës ngecin, veçanërisht nëse marrim parasysh se që viti 2019 në databazë janë futur vetëm 200 objekte dhe me sa duket një projektligj i ri nuk është në horizont. Tutje, asetet e trashëgimisë kulturore që propozohen për mbrojtje të përhershme, me ligj, së pari duhet të paraqiten në KKTK për adoptim ose refuzim.¹²⁴ Në fakt, është KKTK ajo që vendos se cilat asete do të përfshihen

114 Neni 4. Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.

115 Udhëzimi Administrativ (MMPH) nr. 03/2013 për Këshillin Zbatues dhe Monitorues (12 shkurt 2013).

116 RIDEA (Instituti Hulumtues për Zhvillim dhe Çështje Evropiane), "Çështja e trashëgimisë kulturore serbe në Kosovë në kontekstin e 'Finales së Madhe' eventuale mes Kosovës dhe Serbisë", 2019: f. 10. Në dispozicion këtu:

<http://www.ridea-ks.org/uploads/BACKGROUND%20NOTE%20-%20STUDY%20ON%20SRCH%20IN%20KOSOVO.pdf>

117 Misioni i OSBE-së në Kosovë, "Raporti i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve - edicioni i katërt", nëntor 2015: f. 32. Në dispozicion këtu:

<https://www.osce.org/kosovo/209956>

118 Neni 3.3

119 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vendim nr. 69/2016 (10 tetor 2016).

120 https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Vendimet_e_regjistrir_2020-21.pdf për periudhën deri më 10 tetor 2021.

121 https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Regjistri_i_Trash%C3%ABgimis%C3%AB_Kulturore_-_Shqip.pdf

122 https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Regjistri_i_Trash%C3%ABgimis%C3%AB_Kulturore_-_Serbisht.pdf

123 Neni 3.1 i Ligjit për Trashëgiminë Kulturore thotë vetëm se "identifikimi i trashëgimisë kulturore bëhet nga mënyra e inventarizimit dhe implementimit nga ana e Institucionit kompetent."

124 Neni 4.3 i Ligjit për Trashëgiminë Kulturore

në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje të përhershme.¹²⁵ Mirëpo, Këshilli nuk ka qenë funksional që nga themelimi, porse është krijuar vetëm një bord ekzekutiv, ndërsa nuk ka pasur anëtarësi të mirëfilltë.¹²⁶ Për këtë arsye dhe për faktin që Ministria deri më tani ka përfshirë vetëm 23 asete në Listë, duket qartë se mangësitë në zbatim rrezikojnë drejtpërdrejt mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Në përgjithësi, siç ka theksuar Misioni i OSBE-së në Kosovë, Ligji për Trashëgiminë Kulturore është në përputhje me standardet ndërkombëtare, por nuk arrin të sqarojë se cila agjenci / institucion është përgjegjës për cilën detyrë, pasi shprehja “institucion kompetent” përdoret në të gjithë tekstin e ligjit. Kjo paraqet probleme serioze, veçanërisht në fushat e inspektimeve, konservimit dhe restaurimit, lëshimit të lejeve të ndërtimit dhe së këndejmi parandalimit të aktiviteteve të ndërtimeve të paligjshme.¹²⁷

Prandaj, episodet e ndërtimeve të egra që ende paraqiten në ZVM, paqartësitë rreth kompetencave të institucioneve / agjencive të ndryshme përkatëse, dhe së këndejmi reagimet e vonuara të institucioneve në nivelin lokal dhe qendror, tregojnë nevojën për një projektligj të ri për trashëgiminë kulturore¹²⁸ në mënyrë që të eliminohen mangësitë në zbatim, të azhurnohen dhe / ose të përmirësohen dispozitat dhe të sqarohet statusi ligjor, si dhe autoriteti vendimmarrës i KZM-së.¹²⁹ Siç theksohet gjithashtu në raportin më të fundit të Komisionit Evropian *“Kosova duhet të bëjë përparim në hartimin e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, i cili duhet të pasqyrojë me saktësi zotimet e saj sipas Aneksit V të Planit Ahtisaari”*.¹³⁰ Përveç kësaj, duke marrë parasysh Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, në 41 lokalitete fetare të Kishës Ortodokse Serbe, lejohen aktivitete të caktuara vetëm me pëlqimin e KOS.¹³¹ Mirëpo, legjislacioni nuk përkufizon procedurën e saktë me të cilën autoritetet komunale mund të kërkojnë pëlqimin / të paraqesin një kërkesë ose të caktojnë një afat kohor për përgjigje nga KOS.

125 Po aty, neni 4.4

126 Siç paraqitet në uebsajtin zyrtar të Këshillit, versioni në gjuhën shqipe <https://kktk.rks-gov.net/Home/Organization>

127 Misioni i OSBE-së në Kosovë, “Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajitshme materiale në Kosovë”, 2014: f. 10

128 Në vitin 2015, MKRS filloi rishikimin e këtij Ligji për Trashëgiminë Kulturore dhe propozoi një projektligj. Mirëpo, gjatë këtij procesi Ministria nuk arriti të konsultojë dhe të përfshijë komunitetet dhe grupet fetare. Në maj të të njëjtë vit, projektligji u tërhoq pas paraqitjes në Kuvend.

129 RIDEA (Instituti Hulumtues për Zhvillim dhe Çështje Evropiane), “Çështja e trashëgimisë kulturore serbe në Kosovë në kontekstin e ‘Finales së Madhe’ eventuale mes Kosovës dhe Serbisë”, 2019.

130 Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2020, f. 85. Në dispozicion këtu: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

131 Neni 6

Siç theksoi Misioni i OSBE-së në Kosovë në vitin 2015, *“numri i incidenteve që prekin lokalitetet e trashëgimisë kulturore dhe fetare të komuniteteve është tejet shqetësues, me ndikime negative edhe në marrëdhëniet ndëretnike edhe në të drejtat e komuniteteve për ta gëzuar trashëgiminë e tyre edhe për të përfitur nga ajo”*.¹³² Veçanërisht në lidhje me komunitetin serb të Kosovës, viteve të fundit ndërtimet e paligjshme brenda ZVM-ve vazhdojnë të jenë problematike krahas vjedhjes dhe vandalizmit. Shembujt më të spikatur janë ZVM Manastiri i Deçanit, ku është ndërtuar një fermë peshku dhe një restorant, si dhe ZVM e Patrikanës së Pejës, ku janë ndërtuar kasolle prej druri që përdoren për kafene dhe një urë e improvizuar prej druri,¹³³ për të cilat KOS nuk u konsultua dhe nuk iu kërkuar leje sipas ligjit në fuqi.

Kohët e fundit, në vitin 2019, situata ka mbetur e njëjtë me raste të ndërtimeve të pakontrolluara dhe të parregulluara, së bashku me menaxhimin dhe mbrojtjen joadekuate të trashëgimisë kulturore në përgjithësi.¹³⁴ Gjegjësisht, në verën e vitit 2019, Dioqeza e Rashkës dhe Prizrenit e KOS publikoi dy njoftime zyrtare në lidhje me punimet e ndërtimit të paautorizuar në Kishën Katedrale të Shën Nikollës në Novo Bërdë¹³⁵ dhe meshën katolike romake që u shërbye brenda kishës.¹³⁶

ZVM Manastiri i Deçanit dhe kontesti ligjor në lidhje me të meritojnë vëmendje të veçantë. Në maj të vitit 2016, pas 16 vjet ndërgjyqësi, Gjykata Kushtetuese vërtetoi¹³⁷ pronësinë e manastirit mbi 24 hektarë tokë të kontestuar në Komunën e Deçanit. Në të vërtetë, në vitin 1997, qeveria serbe ia ktheu manastirit 24 hektarë tokë si kompensim për 700 hektarë tokë që ishte konfiskuar në vitin 1946. Pavarësisht se ishin regjistruar në kadastër, autoritetet kosovare që nga viti 2002 nuk pranonin që këta 24 hektarë i përkasin Manastirit të Deçanit.

132 Misioni i OSBE-së në Kosovë, “Raporti i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve - edicioni i katërt”, nëntor 2015: f. 33.

133 Po aty

134 Raporti i shoqërisë civile për të drejtat e njeriut në Kosovë në vitin 2019, f. 24-25. Në dispozicion këtu:

https://www.ohchr.org/Documents/Press/kosovo_cso_2019_human_rights_report_en.pdf

135 <https://eparhija-prizren.com/en/statements/communique-raska-prizren-diocese-concerning-unauthorized-construction-work-cathedral-chur/>

136 <https://eparhija-prizren.com/en/statements/roman-catholic-mass-served-grounds-orthodox-church-st-nicholas-novo-brdo-diocese-raska-pr/>

137 https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/KI132-15_SHQ.pdf

Mirëpo, pa zbatuar aktgjykimin e vitit 2016 të Gjykatës Kushtetuese dhe duke shkelur Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura,¹³⁸ autoritetet komunale në vitin 2018 filluan punimet ndërtimore të rrugës ndërkombëtare të transitit Deçan-Plavë¹³⁹ në tokat e manastirit. Në vitin 2019, ndërtimi u ndalua nga Kryeministri i atëhershëm Avdullah Hoti pas një takimi dhe një vendimi të përbashkët me kryetarin e Komunës së Deçanit¹⁴⁰ i cili u rinovua në gusht 2020.¹⁴¹ Në nëntor 2020 dukej se ishte arritur një zgjidhje, kur KZM erdhi të marrëveshja për të ndërtuar një bajpas ndërkombëtar jashtë ZVM-së dhe një rrugë lokale brenda ZVM-së,¹⁴² ndërsa vendimi u nënshkrua nga të gjithë anëtarët e KZM-së, duke përfshirë kryetarin e Komunës së Deçanit. Sidoqoftë, punimet e ndërtimit në përputhje me vendimin e KZM-së ende nuk kanë filluar.

Duke marrë parasysh të gjitha këto ngjarje,¹⁴³ OJQ Europa Nostra - e cila merret me trashëgiminë kulturore dhe natyrore - në prill 2021 përfshiu Manastirin e Deçanit në listën e 7 monumenteve dhe lokaliteteve më të rrezikuara të trashëgimisë në Evropë.¹⁴⁴ Vendimi hasi në kritika të ashpra nga institucionet kosovare, figurat politike dhe shoqëria civile e shqiptarëve të Kosovës, aq sa Kryeministri Kurti dhe Presidentja Osmani dërguan një letër duke u ankuar ndaj OJQ Europa Nostra, ndërsa një grup prej rreth 40 organizatash të shoqërisë civile deklaruan se kjo përfshirje bazohet në të dhëna të rreme dhe të paverifikuara.¹⁴⁵ Debati u ngjyrua edhe me sulme personale ndaj igumenit të Manastirit të Deçanit, Atit Sava Janjić, të cilat përmbahen në një letër / deklaratë nga OJQ Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ).

138 Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, neni 6

139 Komuna e Deçanit ka njoftuar zyrtarisht për ndërtimin e kësaj rruge me komunën malazeze të Plavës.

140 <https://prishtinainsight.com/government-suspends-decan-to-play-road-project/>

141 <https://eparhija-prizren.com/en/news/communique-renewed-continuation-illegal-construction-work-decani-play-high-way-within-visoki-dec/>

142 <https://www.reportdifesa.it/kosovo-statement-by-the-implementation-and-monitoring-council-imc/>

143 Në këtë drejtim, vlen të përmendet se, sipas KFOR-it, asnjë incident i ndjeshëm i sigurisë kundër manastirit nuk është raportuar në dhjetë vitet e fundit. Manastiri i Deçanit është në të vërtetë monumenti i vetëm në Evropë nën një mbrojtje kaq të fortë ushtarake ndërkombëtare. <https://www.gazetaexpress.com/kfor-no-significant-security-incident-was-recorded-in-the-last-10-years-against-decani-monastery/>

144 <https://www.eurpanostrat.org/europa-nostra-and-eib-institute-announce-europes-7-most-endangered-heritage-sites-2021/>

145 <https://kossev.info/harsh-reactions-in-the-kosovo-media-to-decani-monastery-s-inclusion-in-the-7-most-endangered-2021/>

Tensionet ndërmjet komuniteteve në Kosovë vazhdojnë të shfaqen më së shpeshti në formën e sulmeve ndaj trashëgimisë fetare dhe kulturore të komuniteteve të tjera. Monumentet me rëndësi fetare dhe kulturore i janë nënshtruar degradimit të vazhdueshëm që nga përfundimi i konfliktit të armatosur në Kosovë në 1999, duke përfshirë rastet e paradokohshme të vandalizmit, vjedhjes, ndërtimit të paligjshëm dhe shkatërrimit. Dënimi sistematik publik i të gjitha incidenteve të sigurisë që prekin lokalitetet e trashëgimisë kulturore, veçanërisht të komuniteteve jo-shqiptare, dhe ndërmarrja e masave me kohë për të garantuar sigurinë e komuniteteve të prekura janë bazat për krijimin dhe ruajtjen e besimit mes komuniteteve.

VI.

Lidhjet me shtetet e tjera

Njëra nga të drejtat e garantuara për komunitetet jo-shumicë të Kosovës me korvizën aktuale ligjore është e drejta për të mbajtur marrëdhënie me të ashtuquajturin shtet “tjetër”,¹⁴⁶ me fjalë të tjera, shtetin në të cilin komuniteti jo-shumicë në Kosovë është shumicë ose gëzon lidhje të rëndësishme kulturore, shoqërore, ekonomike dhe / ose politike. Në rastin e serbëve të Kosovës, ky shtet është Serbia, ndërsa për boshnjakët qoftë Bosnja dhe Hercegovina dhe / ose Mali i Zi. Kjo përfshin të drejtën për të siguruar mbështetje financiare për institucionet arsimore dhe / ose kulturore në komunitet.

Lidhjet ndërmjet serbëve të Kosovës dhe të Serbisë janë të thella dhe komuniteti vërtet në masë të madhe varet nga këto për mirëqenien e tyre ekonomike dhe shoqërore-politike. Kjo mund të shihet, mbi të gjitha, në praninë e të ashtuquajturave institucione “paralele” që ofrojnë arsim, kujdes shëndetësor dhe shërbime të tjera sociale për komunitetet lokale dhe në tregti. Shumë serbë në Kosovë, veçanërisht ata që jetojnë në pjesët e Kosovës afër Serbisë, mbështeten në masë të madhe te qytetet si Rashka, Vranja, Novi Pazari, Nishi për kujdes mjekësor, punësim dhe shërbime të tjera themelore. Një çështje tjetër që duhet të theksohet është se zyrat administrative për komunat e Kosovës në sistemin serb janë të shpërndara në të gjithë Serbinë, që do të thotë se ato janë pika qendrore për aplikimin për dokumente personale dhe të tjera. Në këtë drejtim, lidhjet mes serbëve të Kosovës dhe Serbisë luajnë një rol të rëndësishëm për ruajtjen e pranisë së tyre në sistemin institucional serb, gjë që prek udhëtimet, të drejtat e votës, si dhe qasjen në sistemin shëndetësor, sistemin arsimor dhe sistemet e mbrojtjes sociale të Serbisë.

Për arsytet e përmendura në seksionet e mësipërme, çdo ndërlikim i marrëdhënieve Kosovë-Serbi ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe shpesh shumë negativ mbi serbët në Kosovë, siç u pa në vitin 2018 me barazimin e taksës prej 100% për mallrat që vijnë nga Serbia ose në ditët e para të pandemisë së COVID-19 kur u bë e pamundur (me një numër të kufizuar të përjashtimeve) të udhëtohej mes Kosovës dhe Serbisë. Gjatë hulumtimit të kryer për këtë raport, shumë serbë të Kosovës vunë re se ndiheshin të shkëputur nga familja, puna dhe shërbimet, me një ndjenjë zhgënjimi dhe izolimi në kohë pasigurie.

146 Kushtetuta e Kosovës, neni 59 (Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre): [Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që] të gëzojnë kontakte të papanguara ndërmjet tyre përbrenda Republikës së Kosovës, dhe të themelojnë e të mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat në cilindo shtet, sidomos me ata që kanë të përbashkët identitetin etnik, kulturor, gjuhësor a fetar, ose trashëgiminë e përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

Ndërsa serbët e Kosovës gëzojnë lidhje të shumta me Serbinë, në formën e mbështetjes institucionale, ekonomike dhe sociale, komunitetet e tjera gjithashtu kanë lidhje që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Shumë **shkolla boshnjake**, për shembull, ndjekin plan-programin zyrtar të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës (FBiH) dhe marrin tekstet mësimore prej tyre, veçanërisht për gjuhën boshnjake. Në këtë drejtim, komuniteti i gjerë ka lidhje të dobëta me Bosnjën, kryesisht për faktin se ata përballen me ndërlikime gjatë udhëtimit atje për shkak të faktit se mbajtësit e pasaportave të Kosovës kanë nevojë për vizë për të hyrë në Bosnjë.¹⁴⁷ Për më tepër, Bosnja dhe Kosova aktualisht nuk kanë marrëdhënie diplomatike, që do të thotë se kontakti shpesh zhvillohet mbi baza joformale dhe *ad-hoc*. Në atë kuptim, lidhjet personale janë më të forta me Malin e Zi, veçanërisht në mesin e pjesëtarëve të komunitetit boshnjak në komunat e Pejës dhe Istogut. Kjo është për shkak të afërsisë së tyre të menjëhershme gjeografike dhe numrit të madh të boshnjakëve që jetojnë në zonat si Rozhaja dhe qytetet e tjera në afërsi.

Nga ana tjetër, **komuniteti turk në Kosovë** ka lidhje të forta kulturore me Republikën e Turqisë në shumë aspekte të jetës së përditshme. Një nga fushat kyçe me rëndësi për këtë komunitet është mundësia e studimit në universitete në pjesë të ndryshme të Turqisë. Ndonëse të rinjtë turq të Kosovës e kanë kuptuar këtë si një mundësi të rëndësishme të ofruar nga shteti turk, numri i studentëve turq të Kosovës që nuk janë kthyer në Kosovë në vitet e fundit është rritur, gjë që në fund pati për rezultat ikjen e trurit. Siç theksoi një nga pjesëmarrësit në grupin e fokusit të mbajtur në Mamushë: *“Të rinjtë tanë turq që arsimohen zakonisht nuk kthehen në Kosovë, që për pasojë e lë Kosovën pa kontributin e tyre (profesional) për shoqërinë në tërësi.”*

Ndryshe nga komunitetet e lartpërmendura, pjesëtarët e komunitetit goran dhe RAE nuk kanë lidhje specifike jashtë Kosovës. Megjithëse, në njëfarë mase, pjesëtarët e komunitetit goran janë të punësuar në të ashtuquajturat “institucione paralele” të financuara nga Serbia, të cilat funksionojnë në jug të Kosovës, ndërveprimi dhe lidhjet me Serbinë janë të natyrës së ndryshme nga ato të serbëve të Kosovës. Duhet shtuar gjithashtu

147 Ministria e Punëve të Jashtme të Bosnjës dhe Hercegovinës, Rregullorja mbi procedurën për lëshimin e vizave për qytetarët e Kosovës*, në dispozicion këtu:

http://www.mvp.gov.ba/konzularne_informacije/vize/Uputstvo%20za%20%20vize%20za%20gradjane%20Kosova-ENG-06122012.pdf

tu se megjithëse pjesëtarët e komunitetit RAE nuk janë të lidhur me një shtet të caktuar, ata megjithatë kanë zhvilluar lidhje kulturore, gjuhësore, politike dhe shoqërore me bashkëkombasit e tyre në të gjithë Evropën, veçanërisht në vendet fqinje siç është Maqedonia e Veriut. Përveç kësaj, shumë pjesëtarë të komunitetit RAE mbajnë lidhje familjare me bashkëkombasit e tyre në rajon.

VII.

Komunitetet joshumicë me numër më të vogël

Malazezët

Malazezët janë një prej komuniteteve joshumicë në Kosovë i cili në regjistrimin e fundit të popullsisë të mbajtur në vitin 2011 është shfaqur në kategorinë “të tjerë”. Një pjesë e pjesëtarëve të këtij komuniteti e ka bojkotuar regjistrimin e popullsisë të asaj kohe, prandaj është e vështirë që të konfirmohet numri i saktë i tyre, edhe pse sipas rezultateve të regjistrimit nga viti 1991 malazezët kanë përfaqësuar një përqindje të rëndësishme të popullsisë në Kosovë (20.365 malazezë në Kosovë). Sipas vlerësimeve të OSBE-së nga viti 2013, në Kosovë kanë jetuar 265 malazezë, që i bie 0,01% të numrit total të popullsisë. Vërtetimin e numrit të saktë të malazezëve më tutje e ka komplikuar fakti që malazezët janë shpërndarë në mënyrë të pabarabartë nëpër Kosovë, si dhe fakti që ekzistojnë ngjashmëritë në identitet, gjuhë dhe kulturë të cilat i ndajnë me pjesëtarë të komunitetit serb.

Për dallim nga komuniteteve të tjera joshumicë, komuniteti malazez nuk ka vende të rezervuara në Kuvendin e Kosovës, por ka të drejtë të emërojë dy (2) përfaqësues në Komitetin Këshillimor për Komunitete. Mungesa e vendeve të rezervuara në Kuvend është pasojë e faktit që ky komunitet nuk është njohur si komunitet brenda kornizave kushtetuese. Megjithatë, është njohur si komunitet joshumicë dhe i barabartë me komunitete të tjera me Ligjin nr. 04/L-020 për ndryshimet dhe shtesat e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë. Mirëpo, pavarësisht që ekzistojnë korniza të caktuara ligjore të cilat në mënyrë të rëndësishme do t'i kontribuonin integritetit të këtij komuniteti dhe pjesëmarrjes së tij në punën e institucioneve, si dhe qasjes së papenguar të shërbimeve, komuniteti malazez në Kosovë ballafaqohet me një sërë problemesh të karakterit sistematik. Sipas informatave të mbledhura gjatë hulumtimit, në tërë Kosovën momentalisht nëpër institucione qendrore dhe lokale janë punësuar vetëm shtatë (7) pjesëtarë të këtij komuniteti. Në bazë të pretendimeve të përfaqësuesve të intervistuar, pengesa kryesore në pjesëmarrjen e tyre në institucione është fakti që malazezët nuk janë njohur me Kushtetutë si komunitet i barabartë joshumicë, dhe rrjedhimisht nuk ekziston një hapësirë për ta që të përfaqësohen në mënyrë institucionale dhe të mbrohen interesat e tyre, gjegjësisht nevojat e këtij komuniteti.

Një problem shtesë në mbrojtjen e interesave të malazezëve në Kosovë është edhe ekzistenca e qëndrimeve të ndryshme politike dhe të vizionit për të ardhme brenda vet komuniteti. Përkundër që për periudhën 2016-2021 është krijuar Strategjia për Afirmimin dhe Integrimin e Komunitetit Malazez në Kosovë, e cila u është dërguar institucioneve qendrore, mungesa e krijimit të planit të veprimit për ta zbatuar si pasojë ka pasur ngecje në përmirësimin e respektimit të të drejtave të këtij komuniteti joshu-

micë. Pikërisht për këtë arsye bashkëbiseduesit gjatë këtij hulumtimi kanë theksuar që momentalisht nuk ekziston një konsensus rreth qëndrimit të përbashkët ndaj institucioneve. Në anën tjetër, një prej kërkesave kryesore të këtij komuniteti ndaj institucioneve mbetet që ky të mos lidhet me komunitetin serb në Kosovë, po që të jetë njohur në tërësi si komunitet i veçantë joshumicë. Sipas pretendimeve të përfaqësuesve të tij, malazezët në Kosovë ende po refuzojnë që të identifikohej si të tillë publikisht, sidomos në mjediset me shumicë serbe. Siç është theksuar, ndihma financiare, shëndetësore dhe sociale të cilën ua ofron Beogradi shpesh çon deri te asimilimi i malazezëve në ato mjedise.

Sfida kryesore në periudhën e kaluar për komunitetin malazez në Kosovë janë kushtet e dobëta socio-ekonomike në të cilat ky gjendet. Shkalla e lartë e papunësisë, mungesa e mbrojtjes institucionale, si dhe pengesa të mëdha të qasja në shërbime të institucioneve ende janë probleme të mëdha për të cilat nuk shihet asnjë zgjidhje. Pos kësaj, siguria e tyre, dhe sidomos në mjedise ku ata janë kthyer pas luftës, është problem me të cilin institucionet nuk janë marrë mjaftushëm. Në këtë kuptim, siç kanë theksuar përfaqësuesit e këtij komuniteti, çështja e sigurisë në mjediset e banuara me malazezë nuk dallon shumë nga ajo e serbëve të Kosovës.

Malazezët në Kosovë nuk kanë qasje në sistem të veçantë shkollor ose në lëndët të cilat do t'ua siguronin ruajtjen e identitetit të tyre. Për më tepër, mundësitë për arsimin e lartë janë goxha të kufizuara dhe përbahen nga ndjekja e njërit nga dy programe ekzistuese shkollore që funksionojnë në Kosovë. Pos kësaj, sikur pjesëtarët e komunitetit serb, ashtu edhe malazezët (e rinj) që duan të punësohen në institucione, po që kanë marrë edukim nga sistemi serb arsimor në Kosovë, nuk kanë mundësi që të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në tregun e punës për shkak të mospranimit të diplomave të tyre. Përkundër kësaj, kanë theksuar që është vërejtur një përmirësim në fushën e qasjes së dokumenteve personale, por që ende ka pengesa të mëdha në procesin e vërtetimit dhe të marrjes së nënshtetësisë, sidomos për persona të zhvendosura.

Një kthesë e rëndësishme në ruajtjen dhe forcimin e jetës kulturore të malazezëve në Kosovë ka qenë hapja e Qendrës Zhvillimore të Malazezëve në Prishtinë, roli i së cilës ishte dashur të ishte përforcimi i raporteve me Malin e Zi, por edhe të shërbente si një vend ku do të mblidhej komuniteti malazez, dhe ku do të ruhej identiteti, kultura dhe tradita e tyre. Sipas përfaqësuesve të këtij komuniteti, punën aktive të këtij institucioni e ka ndaluar pandemia, por edhe mungesa e mjeteve financiare për ta mirëmbajtur institucionin. Në këtë kuptim, komuniteti malazez është duke pritur një ndihmë më të madhe nga Mali i Zi dhe institucionet e Kosovës për ta ruajtur punën e Qendrës Zhvillimore, por edhe një angazhim më të madh në fushën e mbrojtjes së të drejtave të malazezëve në Kosovë, angazhim ky i cili nuk mjaftonte në dekadën e fundit.

Gjatë pandemisë, pjesëtarët e komunitetit malazez ballafaqoheshin me pengesa të ngjashme ose të njëjta sikur edhe komunitete të tjera joshumicë të përmendura në këtë hulumtim. Mungesa e përkthimit të shpejtë dhe të përshtatshëm në gjuhën serbe (të cilën e kuptojnë malazezët) rreth masave të vendosura kundër pandemisë dhe mungesa e ndihmës së drejtpërdrejtë institucionale u kanë pamundësuar pjesëtarëve të këtij komuniteti joshumicë që t'i luftojnë pasojat e shkaktuara nga përhapja e virusit Kovid-19. Për më tepër, për shkak të infomimit të pamjaftueshëm dhe të pengesave gjatë aplikimit për ndihmë ekonomike nr. 15, numri i malazezëve që kanë aplikuar për këtë ndihmë dhe që e kanë marrë prej institucioneve është njëshifror.

Kroatët

Përkundër faktit që kroatët kanë një histori të gjatë dhe të pasur në Kosovë, ky komunitet nuk është njohur brenda kornizave kushetuese dhe ligjore. Arsya për këtë pjesërisht mund të gjendet edhe në mërgimin intensiv të pjesëtarëve të këtij komuniteti nga Kosova për në Kroaci, mërgim ky i cili gjatë viteve nëntëdhjeta ndodhte nga njëra anë në mënyrë të organizuar (me mbështetjen e Qeverisë së Kroacisë), dhe nga ana tjetër ndodhte spontanisht (si pasojë e situatës së keqe socio-ekonomike në mjedise të banuara me kroatë). Rrjedhimisht, sot është e vështirë që të vërtetohet numri përfundimtar i pjesëtarëve të komunitetit kroat të banuar në Kosovë. Sipas vlerësimeve të ndryshme në fshatin Janjevë (Komuna e Lipjanit) dhe Letnicë (Komuna e Vitisë) momentalisht jetojnë nga 200 deri në 300 kroatë të Kosovës.

Përveç përfaqësimit të tyre në kuadër të Komitetit Këshillimor për Komunitete, pjesëtarët e komunitetit kroat nuk kanë të drejtë t'i emërojnë përfaqësuesit e tyre në institucione të nivelit qendror dhe lokal. Një pengesë e këtillë i ka pamundësuar komunitetit kroat në Kosovë që të luftojë për të drejtat dhe interesat e vet në mënyrën më të mirë të mundshme. Si pengesë e zhvillimit të potencialit të këtij komuniteti është edhe gjendja kronikisht e keqe socio-ekonomike dhe tendencat e mërgimit, si dhe mungesa e mbështetjes së madhe institucionale. Për më tepër, pasiguria personale dhe ajo e pronës e cila ekziston te kroatët në një masë të madhe i paracakton planet e tyre për të mbetur në Kosovë. Edhe pse ekziston një mbështetje e madhe e Ambasadës së Kroacisë në Prishtinë, kjo mbështetje nuk mjafton që t'i zëvendësojë pengesat e lartpërmendura me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komunitetit kroat në Kosovë. Në kushte të këtilla, siç pretendojnë bashkëbiseduesit nga ky komunitet, është e domosdoshme që të krijohet një strategji gjithpërfshirëse (institucionale) për mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave, interesave, kulturës dhe gjuhës së kroatëve të Kosovës në një periudhë sa më të afërt.

Sikur pjesëtarët e komuniteteve të tjera joshumicë, kroatët e Kosovës poashtu i kanë ndjerë pasojat e pandemisë. Përveç barrierës gjuhësore e cila ua ka pamundësuar që të informohen me kohë për masat e institucioneve në luftën kundër pandemisë, kroatët e Kosovës janë ballafaquar edhe me pengesa të qasja në kujdesin primar shëndetësor.

Hebrenjtë

Edhe pse hebrenjtë s'kanë qenë të pranishëm në Kosovë në një numër të madh historikisht (në krahasim me vende të tjera në Evropë), ata prapëseprapë kanë rrënjë të thella këtu që prej kohës së Perandorisë Osmane.¹⁴⁸ Për nga numri i saj, popullsia hebrenje ka arritur majën e saj para Luftës së Parë Botërore kur ka pasur nga 1.500 deri në 3.000 hebrenj.¹⁴⁹ Gjatë pushtimit të Kosovës nga Fuqitë e Boshtit në Luftën e Dytë Botërore, hebrenjtë ishin të deportuar në kampe të përqendrimit ku më shumë se gjysma e komunitetit të tyre ishte zhdukur.¹⁵⁰ Si ndoshta grupi më i vogël etnik joshumicë në Kosovë, me rreth pesëdhjetë dhe tetëdhjetë pjesëtarë,¹⁵¹ sot komuniteti hebrenj ndodhet në qytetin e Prizrenit, kurse të tjerët jetojnë në Prishtinë.¹⁵² Nga aspekti historik, Prizreni është selia e kulturës dhe trashëgimisë sefardike në Kosovë, ndërsa Prishtina dikur kishte një numër të madh të sërbishtfolësve nga komuniteti Ashkenazi. Familjet e fundit të këtij komuniteti e kanë lëshuar Kosovën gjatë luftës në vitet e vonëshme 90-ta si pasojë e raporteve të tyre (qoftë të vërteta, qoftë të supozuara) me sërbë. Sot shumica dërrmuese e komunitetit hebrenj janë shqipfolës, ndërsa disa pjesëtarë më në moshë të këtij komuniteti pretendojnë që flasin gjuhën ladino (një përzierje me spanjishten mesjetare).

Edhe pse nuk përballohen me nivele të mëdha të dhunës dhe/ose të diskriminimit, ata prapëseprapë kanë probleme të ngjashme sikur komunitete të tjera joshumicë në Kosovë, siç janë mërgimi i madh jashtë vendit, dëshpërimi ekonomik dhe problemet me ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Përfaqësuesit e komunitetit hebrenj kanë theksuar që autoritetet lokale janë duke dështuar që t'i mirëmbajnë varrezat e tyre siç duhet në Komunën e Prishtinës, Novobërdës, Lipjanit, Prizrenit, Mitrovicës dhe Gjilanit.¹⁵³ Edhe pse Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara ka ndër-

148 For more information see: <https://www.jewishvirtuallibrary.org/kosovo-virtual-jewish-history-tour>. Accessed on 20.03.2021

149 For more information see: <https://jewish-heritage-europe.eu/kosovo>. Accessed on 20.03.2021.

150 For more information see: <https://www.jewishvirtuallibrary.org/kosovo-virtual-jewish-history-tour>. Accessed on 20.03.2021

151 <https://balkaninsight.com/2019/12/11/kosovos-jews-in-race-to-preserve-heritage>. Accessed on 20.03.2021

152 For more information see: <https://www.state.gov/reports/2020-report-on-international-religious-freedom/kosovo/#:~:text=Policy%20and%20Engagement-,Executive%20Summary,groups%20to%20acquire%20legal%20status>. Accessed on 20.03.2021.

153 IBID

marrë përpjekje për t'i rehabilituar varrezat e hebrenjve në Prishtinë, këto përpjekje ende po pritet të ndërmerren në pjesë të tjera të Kosovës.¹⁵⁴ Për më tepër, planet për të ndërtuar një sinagogë në Prishtinë kanë ngecur për shkak të mospajtimeve rreth lokacionit të saj të mundshëm, përkundër faktit që Komuna e ka lëshuar lejen për ta ndërtuar që në vitin 2016.¹⁵⁵ Pos kësaj, komuniteti i është dhënë një ndërtesë në Prizren e cila do të shndërron në sinagogë dhe muze. Përkundër faktit që përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës rregullisht kanë marrë pjesë në ceremoni për ta shënuar Ditën Përkujtimore të Holokaustit, dhe një përmendore e vogël është ngritur në Prishtinë në kujtim të viktimave hebrenje, Holokausti ende nuk mbulohet gjerë në planin mësimor të shkollave fillore dhe të mesme.¹⁵⁶

Që prej botimit të këtij raporti, asnjë hulumtim nuk është bërë me qëllim që të maten nivelet e antisemitizmit ndër popullsinë e përgjithshme të Kosovës. Edhe pse është vënë në pah retorika kundër shtetit të Izraelit ndër akterë të caktuar politik dhe social, kjo nuk është shndërruar në armiqësi ndaj komunitetit lokal hebrenj dhe vendosja e marrëdhënieve të drejtpërdrejta diplomatike mes Kosovës dhe Izraelit në vitin 2020 është mirëpritur nga liderët e komunitetit si një përparim të rëndësishëm.¹⁵⁷ Në nivelin lokal, ka një numër të organizatave joqeveritare hebrenje të cilat promovojnë dhe artikulojnë interesa të komunitetit të cilët i drejtojnë te niveli qendror, më e madhja e të cilave është Bet Israel Kosova, e cila gjendet në Prishtinë. Bet Israel Kosova ka dyzet e pesë (45) anëtarë, dhe punon në promovimin e kulturës, trashëgimisë dhe mirëqenies hebrenje dhe në raporte të mëtutjeshme shqiptaro-hebrenje.¹⁵⁸ Portali i lajmeve online Izraeli Sot ofron mbulim mediatik të çështjeve të hebrenjve dhe të jetës së tyre në Kosovë dhe Shqipëri.¹⁵⁹

¹⁵⁴ <https://balkaninsight.com/2019/12/11/kosovo-jews-in-race-to-preserve-heritage>. Accessed on 20.03.2021

¹⁵⁵ For more information see: <https://www.state.gov/reports/2020-report-on-international-religious-freedom/kosovo/#:~:text=Policy%20and%20Engagement,Executive%20Summary,groups%20to%20acquire%20legal%20status>. Accessed on 20.03.2021

¹⁵⁶ For more information see:

<https://balkaninsight.com/2021/01/27/ceremonies-mark-holocaust-remembrance-day-across-balkans>. Accessed on 21.03.2021

¹⁵⁷ For more information see:

<https://www.jpost.com/opinion/Israels-ties-with-kosovo-what-new-opportunities-await-657476>. Accessed on 21.03.2021

¹⁵⁸ For more information see: <http://betisrael-ks.com>. Accessed on 21.03.2021

¹⁵⁹ For more information see: <https://www.izraelisot.com>. Accessed on 21.03.2021

VIII.

Tre interesa kryesorë të secilit prej komuniteteve joshumicë

Boshnjakët

1. Është e domosdoshme që të përparojë cilësia e arsimit në gjuhën boshnjake përmes furnizimit të papenguar të librave shkollorë dhe zgjerimit të ofertave të drejtimeve në univerzitete (para së gjithash në Prizren dhe Pejë) për hir të zhvillimit të potencialeve të komunitetit boshnjak në Kosovë. Pos kësaj, është e domosdoshme që të përparojë edhe cilësia e shërbimeve të cilat ofrohen në gjuhën boshnjake në institucione lokale dhe qendrore.

2. Arritja e konsensusit të tri partive politike të cilat i përfaqësojnë interesat e boshnjakëve në Kosovë me qëllim që të zgjidhen problemet kryesore të këtij komuniteti, para së gjithash në fushën e arsimit, decentralizimit dhe punësimit.

3. Anulimi i regjimit të vizave me Bosnjë dhe Hercegovinë i cili nuk është një problem i veçantë vetëm për boshnjakët e Kosovës, të cilët nuk mund të udhëtojnë lirshëm në Bosnjë, por është problem i cili e pengon procesin e shkëmbimit ekonomiko-tregtar mes këtyre dy shteteve.

Malazezët

1. Vërtetimi i numrit të pjesëtarëve të komunitetit malazez në Kosovë, me qëllim që të rritet dhe të forcohet mbështetja dhe zhvillimi institucional.

2. Ndërmarrja e aktiviteteve afirmative të drejtuara te komuniteti malazez i cili jeton në Kosovë, me një theks të veçantë në ruajtje dhe përparim të statusit dhe identitetit të tyre gjithpërfshirës.

3. Promovimi dhe integrimi i plotë i komunitetit malazez në shoqëri të Kosovës dhe barazimi i tij me komunitete të tjera joshumicë në Kosovë.

Goranët

1. Forcimi i komponentës ekonomike dhe lufta kundër papunësisë ndër pjesëtarë të komunitetit goran, para së gjithash përmes tejkalimit të barrierës gjuhësore e cila është problem kryesor i konkurrencës në tregun e punës në Kosovë.

2. Vendosja e kushteve të qëndrueshme për ta ndaluar mërgimin e pjesëtarëve të komunitetit goran dhe ikjen e tyre prej Gorës.

3. Mundësimi i qasjes në arsim pjesëtarëve të rinj të komunitetit goran, si parakusht për integrimin e tyre të plotë në shoqëri të Kosovës.

Kroatët

1. Vendosja e kornizës së qëndrueshme për përfaqësimin politik të interesave të komunitetit të kroatëve të Kosovës në nivelin qendror dhe lokal, përmes njohjes zyrtare të këtij komuniteti si komunitet joshumicë në kuadër të Kushtetutës dhe të ligjeve relevante.

2. Adresimi i problemit të papunësisë së lartë, sidomos ndër pjesëtarë të gjeneratave më të reja të kroatëve të Kosovës.

3. Përmirësimi i cilësisë dhe qasja në shërbimet të cilat u ofrohen pjesëtarëve të gjeneratave më të vjetra të kroatëve të Kosovës.

Hebrenjtë

1. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe arkitekturale të hebrenjve të Kosovës.

2. Mundësimi i pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komunitetit të hebrenjve në punën e institucioneve të cilat merren me çështje të të drejtave të komuniteteve joshumicë (sikur është Komiteti Këshillimor për Komunitete).

3. Zbatimi i planit i cili tashmë ekziston për ndërtimin e sinagogave në Kosovë.

Romët, ashkalitë dhe egjiptianët

1. Përfshirja e barabartë dhe e plotë e pjesëtarëve të komunitetit të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në procesin e punësimit dhe mundësimi përfshirës i qasjes në shërbime shëndetësore, arsimore dhe të tjera publike, si faktorë kryesor për integrimin e komunitetit në shoqëri të Kosovës.

2. Forcimi i mekanizmave institucional në luftën kundër diskriminimit i cili është problem kryesor në krijimin e të drejtave themelore të njeriut të pjesëtarëve të komunitetit RAE.

3. Mundësimi i mësimit të gjuhës rome si gjuhë fakultative në institucione arsimore me pranishmëri të madhe të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve.

Sërbët

1. Institucionet e nivelit qendror dhe lokal t'i përmirësojnë kushtet e sigurisë së jetës për sërbët e Kosovës, sidomos për ata që jetojnë në jug të lumit Ibër. Kjo nënkupton ndjekje penale të rasteve të veprave penale të rrezikimit të sigurisë private dhe të pronave, si dhe dënim publik të incidentave nga ana e zyrtarëve të autoriteteve qendrore dhe lokale.

2. Mundësimi i kthimit të qëndrueshëm të sërbëve të zhvendosur në Kosovë, me ndryshime sistematike në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve pronësore në raste të pronave të uzurpuara.

3. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe historike të Kishës Ortodokse Sërbe në Kosovë.

Turqit

1. Ofrimi i arsimit më cilësor në gjuhën turke pjesëtarëve të komunitetit turk, sidomos në nivelin e arsimit të lartë. Poashtu, është e domosdoshme që të sigurohet mësimi i gjuhës shqipe për pjesëtarët e këtij komuniteti në të gjitha nivelet e arsimit.

2. Zgjidhja sistematike e problemit të papunësisë ndër gjenerata më të reja të turqve të Kosovës, me qëllim që të parandalohen mërgimet në rritje të të rinjve të këtij komuniteti që ikin nga Kosova.

3. Investime më të mëdha të institucioneve lokale dhe qendrore me qëllim që të ruhet kultura dhe gjuha e turqve të Kosovës.

Ky botim është mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e këtij institucioni.

